



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. regjistri 8/2018 (JR)
Datë 12.07.2018**

**Vendim nr. 9 (JR)
Datë 24.10.2018**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Luan Daci	Anëtar

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 24.10.2018, ditën e enjte, ora 9:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES:

Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 917 rep., nr. 269 kol., datë 02.03.2018 nga Avokate Ardjana Shehu, me nr. licence 984.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit nr. 17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE E ANKIMIT:

Nenet 62 e 63 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 46, neni 50, germa “c” dhe neni 51 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 17, datë 03.05.2018, ka vendosur:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelineve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Komisioni ka arritur në vendimmarrjen e mësipërme bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke arritur në konkluzionet e mëposhtme.

a. Për vlerësimin e pasurisë, subjekti ka kryer deklaram të rremë mbi të ardhurat e ligjshme për të justifikuar këtë pasuri si të krijuar nga burime të ligjshme, ka përfituar dhe kaluar të drejta reale pronësie sipas kontratës së nënshkruar në vitin 2003 dhe 2005, për pasojë ka fshehur interesin e saj pasuror me personin e lidhur me të, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar ligjshmërinë e likuiditeteve në vitet 2007, 2009 dhe 2015 e për pasojë ka kryer deklaram të rremë, si dhe deklarime të pasakta.

b. Për denoncimin nga publiku, Komisioni ka gjykuar se sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke mos ndërmarrë veprim ligjor lidhur me deklaramin e konfliktit të interesit në vendimin nr. 46, datë 03.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese, nuk arrin nivel të besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

2. Kundër vendimit nr. 17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), brenda afatit ligjor, rezulton të jetë ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj. Ky ankim ishte i plotë edhe në elementet e tjera, si të formës edhe të përmbajtjes. Për rrjedhojë, Komisioni me vendimin e tij nr. 5, datë 19.06.2018, ka vendosur: “Pranimin e akimit të datës 19.06.2018, me nr. 3929/5 prot., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, si ankim i plotë dhe në përputhje me nenin nr. 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012).

II. Shkaqet e ankimit

Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, është ankuar ndaj vendimit nr. 17, datë 03.05.2018, të Komisionit duke paraqitur shkaqet si më poshtë:

3. Në zbatim të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka dalë jashtë kuadrit ligjor kushtetues, pasi subjekti ka dorëzuar një deklaratë të re, të plotë të pasurisë. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) është organi që kryen vlerësimin e pasurisë, si organ i specializuar për administrimin e deklarimeve të pasurisë dhe kontrollit ndaj tyre, i cili në rastin konkret i ka dërguar Komisionit raportin, sipas të cilit është konstatuar se deklarimi ka qenë i vërtetë, i plotë dhe pa fshehje pasurie nga subjekti.
4. Komisioni, sipas rezultateve të hetimit administrativ, si dhe referuar relatimit në seancën dëgjimore, nuk konstatoi që subjekti të kishte pasuri të fshehura, deklarime të rreme ose pasaktësi, burime të paligjshme etj. Për rrjedhojë, duke u bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për subjektin që përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuri, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Pra, është cenuar kështu parimi i procesit të rregullt ligjor.
5. Bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, shkarkimi jepet si masë disiplinore kur rezulton se subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe ky kriter është lehtësisht i provueshëm. Nëse një parashikim i tillë do tejkalohet, atëherë Komisioni në vendimin e tij mund të vendoste në favor të masës ekstreme të shkarkimit.
6. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 shkarkon subjektin nga detyra kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të këtij ligji, në një kohë që grupet e punës në Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe ILDKPKI në raportet e tyre përkatëse paraqitën deklaram të sakta dhe në përputhje me ligjin. Nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë argument nga shumica për papërshtatshmërinë e kontrollit të figurës.
7. Në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, kur është miratuar në vitin 2003, nuk parashikohej detyrimi i deklaramit të veprimeve juridike, por vetëm deklarami i pasurive dhe i të drejtave reale mbi to, madje subjekti shpjegon se një pretendim i tillë nuk ekziston as sot me ndryshimet që ka pësuar ligji. Sipas subjektit, Komisioni vendos detyrime të reja ligjore për subjektet, duke mbajtur kështu një qëndrim të njëanshëm dhe të qëllimshëm.
8. Komisioni, pas mbylljes së hetimit administrativ, i ka dërguar pyetje të tjera subjektit të rivlerësimit dhe, pa prituri të kthehen përgjigjet, e ka njoftuar subjektin për seancën dëgjimore. Komisioni, më datë 25.04.2018, shtyn datën e shpalljes së vendimit për më datë 03.05.2018, për të bërë llogaritje të tjera, në një kohë që subjekti nuk ka dorëzuar materiale ditën e seancës.
9. Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim se përse nuk pranohen komunikimet me subjektin, por ka përdorur rezultatet e hetimit kryesisht, të cilat janë përfshirë në vendim si fshehje dhe deklaram i rremë. Nga kjo rrjedh që seanca dëgjimore ka qenë një formalitet që nuk ka sjellë asnjë vlerë të shtuar.
10. Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë në Shqipëri që prej muajit gusht 2016, ndaj pjesa e tij e deklaramit i është dërguar me postë dhe më pas i është bashkëlidhur deklaramit të subjektit. Ndaj subjekti shpjegon se bashkëjetuesi nuk kishte udhëzime nëse duheshin deklaruar veprimet juridike ndër vite apo jo. Subjekti në këtë shkak arsyeton se Komisioni nuk

bën diferencën dhe pikat e përbashkëta ndërmjet ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049) me ligjin nr. 84/2016.

11. Barra e provës i është kaluar subjektit në shkelje të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni i ka kaluar barrën e provës për periudhën 1995-2001 të personit të lidhur, si dhe barrën e provës për veprimet që ka kryer Agjencia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale (në vijim ALUIZNI) duke qenë institucion shtetëror.
12. Ligji i rivlerësimit nuk është prapaveprues, ndaj këtë parim e ka shkelur Komisioni gjatë verifikimit dhe, si i tillë, neni 31 i ligjit nr. 84/2016 nuk ka fuqi prapavepruese. Është plotësuar deklarata në përputhje me këtë nen, por Komisioni ka kërkuar zbatimin e tij që nga viti 2003.
13. Komisioni ka zbatuar keq ligjin nr. 84/2016, pasi në bazë të tij subjekti ka pasur detyrim të deklarojë vetëm për personat madhorë të familjes bashkëjetuese, prandaj në vitin 2005 ka bërë deklarime vetëm për bashkëjetuesin (këtë vit subjekti është shkëputur nga trangu i origjinës) dhe nuk kishte detyrim të deklaronte për familjarët e origjinës, ashtu sikundër nuk ka pasur detyrim të deklaronte për bashkëjetuesin përpara kësaj periudhe kur subjekti jetonte me familjarët e tij të origjinës.
14. Komisioni ka shkelur ligjin gjatë procesit të rivlerësimit për kufizimin e deklarimeve vetëm te personat e lidhur, sipas përkufizimit përkatës të ligjit nr. 84/2016, duke shkelur të drejtat e personave të lidhur sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale të personave familjarë të subjektit, por që për efekte të këtij ligji nuk konsiderohen persona të lidhur.
15. Subjekti pretendon se në vendimin nr. 17 të Komisionit, shumica barazon termin “pasuri” me “veprimin juridik” duke shkelur haptazi nenin 3, pikën 11 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ligjin nr. 9049 të pandryshuar. Si rrjedhojë, subjekti nuk kishte asnjë detyrim ligjor të deklaronte veprimet juridike në të cilat kishte marrë pjesë, por që nuk kishin asnjë ndikim në shtimin apo pakësimin e pasurisë. Për pasojë, subjekti nuk kishte nënshkruar asnjë kontratë shitblerjeje pasurie gjatë vitit 2003 që të fitonte të drejta pasurore. Ndaj shumica në vendim, duke mos bërë dallimin e veprimit juridik me pasurinë, i kanë vendosur detyrimin për deklarimin e veprimit juridik, kur një gjë e tillë nuk ekzistonte as në vitin 2003. Në këtë pikë nuk mund të flitet për shitje apo kalim pronësie, pasi personi i lidhur nuk ka pasur asnjëherë të drejta pronësie mbi këtë apartament dhe nuk mund të kalonte të drejta që nuk i kishte. (Ky shkak ligjor do të trajtohet më gjerësisht, pasi është një shkak i përsëritur disa herë nga subjekti në ankim dhe përbën shkakun kryesor të pasurisë nr. 1.)
16. Subjekti mendon se nuk ka pasur në asnjë rast interesa pasurore, pasi ajo çka konsiderohet pasuri sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 është çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme brenda dhe jashtë territorit shqiptar, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049, të ndryshuar, ndaj këtu nuk hyjnë veprimet juridike dhe një gjë e tillë nuk ishte e parashikuar as në vitin 2003 dhe as sot, në vitin 2018.
17. Tjetër shkak ankimor është se veprimet juridike, si deklarata noteriale e datës 07.03.2005 (për likuidimin e shumës 56000 euro nga {***}), ashtu edhe kontrata e sipërmarrjes për porositjen e apartamentit objekt shqyrtimi, janë nënshkruar nga bashkëjetuesi, sepse ka qenë pikërisht ai që ka bërë shlyerjen e apartamentit 1 + 1 (2003).
18. Subjekti pretendon se argumentet që personi i lidhur nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të shlyer apartamentin 1 + 1 janë të pavërteta, sepse i ka nga puna e tij dhe bursa në Itali për periudhën 1992-2001.
19. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nr. 1, subjekti pretendon se për personin e lidhur, i cili ka qenë student gjatë periudhës shtator 1992 - korrik 1995, është marrë në konsideratë

standardi i një studenti italian, por jo standardi i një studenti të huaj, në kuptimin që i janë përlllogaritur më shumë shpenzime nga sa mund të ketë kryer.

20. Qenia në marrëdhënie pune e personit të lidhur për vitet 1995-2000, provohet me kontratën e punës me shoqërinë {***}, si dhe listëpagesat dhe dokumentet bankare të derdhjeve të pagës në llogari.
21. Subjekti në lidhje me pasurinë nr. 2 pretendon se duke bashkëjetuar me personin e lidhur ka pasur ekonomi të përbashkët dhe jo të karakterizuar nga mosmarrëveshjet, ndaj është e vështirë të thuhet se sa ka qenë kontributi i njërit apo i tjetrit, duke i sugjeruar Komisionit që ta ngarkojnë me masën 50% kontribut, pasi është e vetmja pasuri që ka arritur të kontribuojë me të ardhurat e tij. Nga ana tjetër, subjekti pretendon se jo çdo shpenzim dhe çdo likuidim është kryer në masën 50%.
22. Në lidhje me pasurinë nr. 3, sipas subjektit rezultoi e provuar me kërkesën (formular tip) drejtuar ALUIZNI-t më datë 08.10.2010, nga subjekti i rivlerësimit, znj. Xhoxhaj, dhe personi i lidhur, se sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë është 50 m² (vetëm njolla nën apartament). Me këtë kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar është vënë në lëvizje ALUIZNI duke përgatitur dokumentacionin për dhënie trualli në pronësi.
23. Në lidhje me pasurinë nr. 4, subjekti ngre si shkak ankimor se nuk ka pasur mungesë të burimit financiar për të justifikuar likuiditetet në vitet 2007, 2009, 2015, duke pretenduar se rezultatet e Komisionit janë të pabazuara në provat shkresore të paraqitura.
24. Në lidhje me çështjen nr. 5 të trajtuar nga Komisioni, subjekti pretendon se argumentimi i Komisionit se nuk ka asnjë dokumentacion për të provuar se për cilën pasuri është disbursuar kredia është i pabazuar, pasi ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin që i përket kësaj kredie, me kontratën dhe mandatarkëtimet që i përkasin vlerës së apartamentit.
25. Subjekti pretendon se deklarimi për pasurinë truall me sipërfaqe 666 m², e cila është në pronësi të nënës së tij, të cilën në deklaratat e vitit 2003 e ka deklaruar si pjesë takuese me 1/4, ka ardhur për shkak se ka jetuar me prindërit dhe motrën në të njëjtën përbërje familjare, pra e ka konsideruar pronë të përbashkët, si dhe duke iu referuar nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003 që kërkonte deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar (sot i shfuqizuar).
26. Subjekti pretendon se duke qenë në një përbërje familjare me babain, i cili gjithashtu ka qenë subjekt deklarimi, i ka plotësuar deklaratat e pasurisë në të njëjtën mënyrë si kryefamiljari, pasi ka vlerësuar se duhej të deklaronin të gjithë pasurinë e familjes, pra të çdo pjesëtari të saj dhe jo sepse ka pasur ndonjë pasuri më vete të regjistruar në emrin e tij.
27. Subjekti ngre si shkak ankimor, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, se nuk ka qenë kurrë në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të bëra me ligj dhe në asnjë rast tjetër. Sipas subjektit, ka gjykuar një çështje në përputhje të plotë me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe me dispozitat përkatëse të legjislacionit civil. Ndërsa në gjykimin penal në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku relator ishte babai i subjektit, është trajtuar parashkrimi i ndjekjes penale si shkak ankimor dhe nuk është gjykuar themeli i çështjes. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka zbatuar standardin e Komisionit të Venecias mbi prevalimin e funksionimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi procedurën e ardhjes së çështjes për shqyrtim dhe procedurave të tjera para shqyrtimit gjyqësor

28. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, i cili parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.”.
29. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012.
30. Trupi gjykues fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegj dhe, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i saj është depozituar brenda afatit ligjor.
31. Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, më datë 15.10.2018, së bashku me parashtrimet e saj para gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi ka paraqitur aktet e reja si vijojnë:
1) vërtetim pa datë i administratorit të shoqërisë “{***}” (një faqe); 2) një faqe e printuar e komunikimit me postë elektronike mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur; 3) shkresë e thjeshtë pa datë dhe vulë “Apostile” në gjuhën italiane, e përkthyer dhe e noterizuar (tri faqe).
32. Këto akte të reja nuk u pranuan për shqyrtim nga trupi gjykues, pasi nuk u paraqitën në përputhje me parashikimet ligjore, përkatësisht me nenin 49, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012 sipas të cilit: “Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 (pesë) ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”, por në asnjë rast kjo dispozitë nuk parashikon paraqitjen e shkaqeve dhe provave të reja. Njëkohësisht, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, në Kolegj, me ankim, nuk mund të paraqiten prova të reja përderisa ankuesi nuk provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto prova më parë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj nuk argumentoi se pa fajin e saj këto prova nuk mundën të paraqiteshin në Komision. Gjithashtu, trupi gjykues refuzoi marrjen e provave bashkëngjitur parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar edhe në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
33. Në Kolegj janë paraqitur respektivisht në datat 08.05.2018, 02.05.2018 dhe 26.03.2018 denoncime për subjektin e rivlerësimit nga shtetasit {***}, {***} dhe {***}. Trupi gjykues pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi për mosfillimin e hetimit kryesisht për praktikën e denoncimeve të shtetasve {***}, {***} dhe {***}, pasi nuk përmbanin shkaqe të mjaftueshme për t’u hetuar.
34. Nëpërmjet ankimit nuk është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për më tepër, trupi gjykues kryesisht çmoi se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e palëve është i panevojshëm, pasi : a) vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale apo gjendja faktike e konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga

Komisioni; c) nuk vlerësohet e nevojshme nga trupi gjykues përsëritja e marrjes së disa apo të të gjitha provave të marra në Komision.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues pasi vlerësoi kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, vendosi të zhvillojë shqyrtimin e vendimit të Komisionit nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, mbi bazë dokumentesh.

35. Subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë që prej vitit 2010. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti Xhoxhaj i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Duke qenë se znj. Altina Xhoxhaj është gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi.
36. Gjatë hetimit administrativ, mbështetur në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, Komisioni ka administruar raportet nga institucionet kompetente në lidhje me vlerësimet e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Komisioni me vendimin nr. 1, datë 14.11.2017, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për tri kriteret e vlerësimit, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.
37. Më datë 16.03.2018, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, duke u bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes. Këto rezultate iu njoftuan edhe subjektit më datë 19.03.2018, duke i njoftuar njëkohësisht edhe kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që të provonte të kundërtën në rast se do të kishte prova.
38. Ndërkohë, raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i ILDKPKI-së, me nr. 622/23 prot., datë 06.01.2017, ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, nga i cili ka rezultuar se për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj: a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
39. Komisioni, me vendimin nr. 17, datë 03.05.2018, bazuar në provat që janë disponuar, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, ka vendosur që për subjektin e rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese, të jepet masa disiplinore shkarkim nga detyra.
40. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, ankim i nënshkruar nga avokatja Ardjana Kalo, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit nr. 17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, duke parashtruar në ankimin e saj vetëm shkaqet mbi të cilat mbështeten pretendimet e saj. Më datë 15.10.2018, nëpërmjet përfaqësueses, avokates Ardjana Kalo, subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, në mbështetje të ankimit të saj, paraqiti parashtrime konform pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, parashtrime këto që u shqyrtuan nga Kolegji.

IV. Analiza e shkaqeve ligjore të pretenduara në ankim

41. Subjekti pretendon se në zbatim të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka dalë jashtë kuadrit ligjor kushtetues, pasi subjekti ka dorëzuar një deklaratë të re, të plotë të pasurisë. ILDPKI-ja është organi që kryen vlerësimin e pasurisë si organ i specializuar për administrimin e deklarimeve të pasurisë dhe kontrollit ndaj tyre, i cili në rastin konkret i ka dërguar Komisionit raportin sipas të cilit është konstatuar se deklarimi ka qenë i vërtetë, i plotë dhe pa fshehje pasurie nga subjekti.
42. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit arsyeton se, duke u nisur nga sa parashikon Kushtetuta dhe ligji për plotësimin e deklaratës “vetting” dhe shprehjes së ILDPKI-së për konstatimet në këto deklarime, nuk e përjashton Komisionin apo Kolegjin nga kontrolli i këtyre deklarimeve, të cilat jo pa qëllim i dërgohen që nga viti 2003. Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha se sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”. Ndërkohë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës, ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën e pasurisë “vetting”. Komisioni apo Kolegji, këto deklarata, së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Përveç kësaj, Komisioni ushtron kontroll edhe mbi aktin administrativ që është raporti i ILDPKI-së për provueshmërinë dhe vërtetësinë e tij.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i mësipërm i subjektit, i trajtuar si shkak ligjor, nuk qëndron.

43. Subjekti pretendon se sipas rezultateve të hetimit administrativ, si dhe referuar relatimit në seancën dëgjimore, nuk u konstatua që subjekti të kishte pasuri të fshehura, deklarime të rreme ose pasaktësi, burime të paligjshme etj. Për rrjedhojë, duke u bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës subjekti që përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuri, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit, duke cenuar kështu parimet e procesit të rregullt ligjor.
44. Trupi gjykues i Kolegjit verifikoi aktet në dosje, saktësisht rezultatet e hetimit kryesisht, sipas të cilit Komisioni për çdo pasuri ka dhënë rezultatin e hetimit, konkretisht: mospërputhje të deklarimeve, të ardhura të pamjaftueshme, mungesë të burimit financiar, duke i kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Po kështu, edhe në procesverbalin e zbardhur

të seancës dëgjimore të datës 23.04.2018, janë cituar të gjitha rezultatet e hetimit dhe barra e provës që i ka kaluar subjektit. Me kalimin e barrës së provës, kuptohet që subjekti duhet të paraqesë prova dhe shpjegime për të provuar bindshëm të kundërtën e asaj çfarë ka konstatuar Komisioni kur ky i fundit arrin përfundimin se provat kanë nivel provueshmërie sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016. Sa i përket konstatimit të fshehjes ose të paraqitjes në mënyrë të pasaktë, ky është një rezultat i cili vjen në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pasi janë paraqitur pretendimet dhe provat e subjektit. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaratimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Në këtë proces subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e mësipërme të subjektit në lidhje me padijeninë e konstatimit të fshehjes së pasurisë dhe të deklarimeve të rreme nuk qëndrojnë, pasi këto janë rezultatet e hetimit të plotë, të cilat janë pasqyruar në vendim. Për më tepër, nuk konstatohet se subjekti, nga Komisioni, t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes dhe përfaqësimit, të drejtën për t'u njohur me dosjen dhe të drejtën për të dhënë mendime dhe shpjegime.

45. Subjekti pretendon se bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, shkarkimi jepet si masë disiplinore kur rezulton se subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe ky kriter është lehtësisht i provueshëm. Nëse një parashikim i tillë do të tejkalohet, atëherë Komisioni në vendimin e tij mund të vendoste në favor të masës ekstreme të shkarkimit.
46. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit konstaton se Komisioni me vendimin nr. 17, datë 03.05.2018, nuk e ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit për efekt të kalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, sipas nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të këtij ligji për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky shkak i mësipërm, i ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, është i pabazuar.

47. Subjekti parashtron si shkak ankimi se parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 shkarkojnë subjektin nga detyra kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të këtij ligji, në një kohë që grupet e punës në DSIK dhe ILDKPKI në raportet e tyre përkatëse paraqitën deklarime të sakta dhe në përputhje me ligjin. Nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë argument nga shumica për papërshtatshmërinë e kontrollit të figurës.
48. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, sa i përket kontrollit të figurës, Komisioni ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, ndërsa për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar deklarim të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. Shkarkimi i

subjektit të rivlerësimit nga detyra nuk ka ardhur si pasojë e papërshtatshmërisë së tij gjatë kontrollit të figurës, por nga kontrolli i pasurisë ku janë konstatuar pasaktësi, deklarime të rreme dhe të pamjaftueshme. Fakti që në kontrollin e figurës subjekti vlerësohet i përshtatshëm, nuk përthith edhe përshtatshmërinë në kontrollin e pasurisë në rastet e deklarimit të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. Në nenin 61, pika 3, këto dy raste parashikohen si raste në kuadër të pamjaftueshmërisë në deklarim, por nuk kërkohet që ato të ekzistojnë detyrimisht njëkohësisht që të përbëjnë shkak për shkarkim, pasi ato janë kritere vlerësimi të ndara, të cilat trajtohen dhe hetohen më vete. Në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të kritereve ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkak i mësipërm i ankimit, i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i bazuar.

49. Subjekti ka pretendime se ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049), kur është miratuar në vitin 2003, nuk parashikonte detyrimin e deklarimit të veprimeve juridike, por vetëm të pasurive dhe të të drejtave reale mbi to, madje subjekti shpjegon se një pretendim i tillë nuk ekziston as sot, me ndryshimet që ka pësuar ligji. Sipas subjektit, Komisioni vendos detyrime të reja ligjore për subjektet, duke mbajtur kështu një qëndrim të njëanshëm dhe të qëllimshëm.
50. Nga trupi gjykues u verifikua ligji nr. 9049 i papërditësuar, nga fletorja zyrtare nr. 31, publikuar në maj 2003, në nenin 4 të të cilit parashikohet:
“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë:
a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 5.000 dollarë amerikanë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.”
- Në hetimin paraprak dhe të thelluar, Komisioni ka konstatuar veprime juridike të dyanshme, të cilat në themel të tyre kanë vullnetin e personave që i nënshkruajnë, nëpërmjet të cilave janë transferuar të drejtat reale mbi sende të paluajtshme, kundrejt çmimit të përcaktuar në to. Të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme përbënin detyrim për subjektet e rivlerësimit edhe për deklarimet që ata kanë paraqitur çdo vit për gjendjen e pasurive dhe burimin e krijimit të tyre. Për më tepër, është fakt se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet këtyre veprimeve juridike, konstatohet se ka marrë dhe ka dhënë likuiditete në *cash* nga shitja e të drejtave reale mbi sendet e paluajtshme. Në nenin 164 të Kodit Civil parashikohet: “Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit [...]”. Kontrata është veprim juridik dhe, si e tillë, në rastin konkret i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, znj. Xhoxhaj, titull pronësie, pra ndryshe nga sa pretendon ajo në ankim.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, ndaj është i pabazuar.

51. Subjekti pretendon se Komisioni, pas mbylljes së hetimit administrativ, i ka dërguar pyetje të tjera subjektit të rivlerësimit, i cili pa pritur të kthehen përgjigjet, e ka njoftuar për seancën dëgjimore. Komisioni, më datë 25.04.2018, shtyn datën e shpalljes së vendimit për më datë 03.05.2018 për të bërë llogaritje të tjera, në një kohë që subjekti nuk ka dorëzuar materiale ditën e seancës.
52. Trupi gjykues vlerëson se mbyllja e hetimit administrativ kryesisht, nënkupton mbyllje të hetimit që bën Komisioni pa përfshirë subjektin e rivlerësimit, përveç dorëzimit të pyetësorëve, por pas njoftimit të tij me konkluzionet dhe aktet e hetimit si dhe për kalimin e barrës së provës, hetimi vazhdon duke ftuar edhe subjektin të njihet me aktet e dosjes, të paraqesë prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit ditën e seancës dëgjimore, datë 25.04.2018, ka paraqitur parashtrimet me shkrim, të cilat konsiderohen materiale, si dhe mandatpagesa të shkollës së fëmijëve, të cilat janë dorëzuar në datën 18.04.2018, ndaj Komisioni e ka parë të arsyeshme të bëjë llogaritje të tjera në mënyrë që subjektit t'i garantohet një proces i rregullt ligjor.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaku i mësipërm i ankimit, ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i bazuar.

53. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim pse nuk pranohen komunikimet me subjektin, por ka përdorur rezultatet e hetimit kryesisht, të cilat janë përfshirë në vendim si fshehje dhe deklaram i rremë. Nga kjo rrjedh që seanca dëgjimore ka qenë një formalitet që nuk ka sjellë asnjë vlerë të shtuar.
54. Trupi gjykues arsyeton se Komisioni në vendimin e tij nr. 17, datë 03.05.2018, ka arsyetuar pse nuk i janë pranuar argumentet subjektit të rivlerësimit, duke i kundërshtuar ato me rezultatet e hetimit. Ndërsa, për sa i përket provueshmërisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur provat që i ka kërkuar Komisioni, ndërkohë që edhe niveli i provueshmërisë për gjetjet dhe vlerësimet e Komisionit ka mbetur prej saj thjesht në planin deklarativ. Trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur duke u bazuar në provat që disponoheshin, si dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi. Komisioni nuk mund të konkludonte për fshehje dhe deklaram i rremë gjatë hetimit, përderisa procesi i shqyrtimit vazhdonte, më tej do të zhvillohej seanca dëgjimore dhe subjekti në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, kishte të drejtë të paraqiste prova, materiale, shpjegime dhe parashtrime të tij. Nëse Komisioni do të konkludonte për fshehje dhe deklaram i rremë në përfundim të hetimit paraprak, atëherë ai do të paragjykonte çështjen, pasi me kalimin e barrës së provës subjektit, mund të ndodhte që me provat e sjella si gjatë hetimit, ashtu dhe në seancën dëgjimore, mund të përmysej rezultati i hetimit.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaku i mësipërm i ankimit, i ngritur nga subjekti, nuk qëndron dhe është i pabazuar.

55. Subjekti pretendon se bashkëjetuesi i saj nuk ka qenë në Shqipëri që prej muajit gusht 2016, ndaj pjesa e tij e deklaramit i është dërguar me postë dhe më pas i është bashkëlidhur deklaramit të subjektit. Ndaj subjekti shpjegon se bashkëjetuesi nuk kishte udhëzime nëse duheshin deklaramit veprimet juridike ndër vite apo jo. Subjekti në këtë shkak arsyeton se Komisioni nuk dallon ndryshimet dhe pikat e përbashkëta të ligjit nr. 9049 me ligjin nr. 84/2016.
56. Në këtë shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se subjekti ka një tërheqje nga shkaqet e mëparshme ku pretendonte se Komisioni nuk bën dallimin mes veprimit juridik dhe pasurisë, ndërsa në këtë rast thotë se bashkëjetuesi nuk kishte udhëzime nëse duheshin deklaramit

veprimet juridike, duke pranuar në mënyrë indirekte deklarin e tyre. Nëse bashkëjetuesi nuk kishte udhëzime dhe nuk kishte njohuri juridike për të interpretuar ligjin, siç pretendohet në ankim, për subjektin e rivlerësimit nuk mund të thuhet e njëjta gjë.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaku i mësipërm i parashtruar nga subjekti i rivlerësimit nuk gjen mbështetje logjike dhe ligjore.

57. Subjekti pretendon se barra e provës i është kaluar në shkelje të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi sqaron se Komisioni i ka kaluar gabimisht barrën e provës për periudhën 1995-2001 të personit të lidhur, si dhe barrën e provës për veprimet që ka kryer ALUIZNI duke qenë institucion shtetëror.
58. Trupi gjykues vlerëson se nga hetimi kryesisht i Komisionit ka rezultuar se për burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave në lidhje me pasurinë nr. 1, apartament banimi me sipërfaqe 101 m², regjistruar në ZRPP, me kontratën e shitjes nr. 2908 rep. dhe 629 kol., datë 07.12.2011, ka mungesë dokumentacioni, deklarin të rremë dhe fshehje të të ardhurave. Duke qenë se burimi i krijimit të kësaj pasurie ishte deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003, si burim krijimi nga të ardhurat e personit të lidhur në Itali për vitet 1992-2001, ndërsa nga personi i lidhur është deklaruar në vitin 2005, burim krijimi nga të ardhurat e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 93 m² në Bulevardin “{***}”, si dhe kursimet vjetore. Për më tepër, apartamenti me sipërfaqe 93 m² është përfituar me kontratën e sipërmarrjes me nr. 115 rep. dhe nr. 17 kol., datë 31.03.2003, e lidhur mes {***} dhe Altina Xhoxhajt me shoqërinë e ndërtimit “{***}” SHPK, kontratë e cila nuk rezulton të jetë gjetur nga kërkimet e Komisionit dhe as paraqitur nga subjekti, por që ka rezultuar e cituar në kontratën e sipërmarrjes me nr. 479 rep. dhe 66 kol., datë 07.03.2005, të lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” SHPK me {***} e Altina Xhoxhajn dhe {***}. Si rezultat i këtyre mospërputhjeve në deklarime dhe dokumentacion, Komisioni, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të sjellë dokumentacion justifikues, për të provuar të kundërtën e mospërputhjes që ka rezultuar në hetimet e Komisionit, ndërmjet deklarimeve të tij dhe të personit të lidhur për burimin e krijimit të së njëjtës pasuri. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kalimin e barrës së provës institucionit shtetëror, ALUIZNI-t, nuk është i bazuar pasi barra e provës i ka kaluar subjektit për arsye se rezulton mospërputhje e sipërfaqes 50 m² e kërkuar për blerje prej tij, sipërfaqes 122,89 m² që i takonte subjektit bazuar në përllogaritjet e ALUIZNI-t dhe sipërfaqes 221 m² që i është dhënë subjektit nga ALUIZNI. Pra, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të provuar dhe argumentuar arsyen e këtyre mospërputhjeve në deklarime dhe dokumentacion dhe përse ka përfituar nga ALUIZNI më shumë nga sa i takonte.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

59. Subjekti i rivlerësimit ngre si shkak në ankim se ligji nuk është prapaveprues, ndaj këtë parim e ka shkelur Komisioni gjatë verifikimit dhe, si i tillë, neni 31 i ligjit nr. 84/2016 nuk ka fuqi prapavepruese. Është plotësuar deklarata në përputhje me këtë nen, por Komisioni ka kërkuar zbatimin e tij që nga viti 2003.
60. Trupi gjykues arsyeton se dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha se sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë

deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Gjithashtu, neni 31 i ligjit nr. 84/2016 të referon te neni 33 i këtij ligji, i cili parashikon në pikën 1 të tij se ILDPKI-ja kryen një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin nr. 84/2016, ligjin nr. 9049/2003, si dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367). Sipas këtij parashikimi, verifikimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre, dokumentacionit justifikues ose informacioneve për pasuritë në pronësi apo përdorim të subjekteve të rivlerësimit, nuk kufizohet vetëm në deklaratimet e pasurisë sipas deklaratës “vetting”, por edhe në deklaratimet periodike të pasurisë. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelit. Për më tepër, edhe pika 1 e nenit 50 të ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit”. Mbi raportin e ILDPKI-së, shoqëruar edhe me deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit, bën hetim edhe Komisioni, nga ku rezulton se nuk mund të kufizohet vetëm në deklaratimet e vitit 2016 të deklaratës “vetting”.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkak i mësipërm i ankimit, i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, është i pabazuar.

61. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka zbatuar ligjin nr. 84/2016, pasi në bazë të tij subjekti ka pasur detyrim të deklarojë vetëm për personat madhorë të familjes bashkëjetuese dhe për këtë arsye në vitin 2005 ka bërë deklaratime vetëm për bashkëjetuesin (këtë vit subjekti është shkëputur nga trangu i origjinës) dhe nuk kishte detyrim të deklaronte për familjarët e origjinës, ashtu si kundër nuk ka pasur detyrim të deklaronte për bashkëjetuesin përpara kësaj periudhe kur subjekti jetonte me familjarët e saj të origjinës.
62. Trupi gjykues arsyeton se deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit përfshijnë edhe persona të cilët nuk janë në certifikatën familjare, kur pasuritë dhe burimi i krijimit të tyre afektojnë njëra-tjetrën në kohë të ndryshme dhe kalimet e pronësisë janë bërë ndërmjet familjarëve. Nuk detyrohet të deklarojë nga Komisioni për persona të cilët nuk janë në certifikatën familjare aktuale, përveç atyre që parashikon ligji, por detyrimi vjen si pasojë e saktësisë së deklaratimit në transaksionet ku janë përfshirë edhe familjarët e tjerë.
Neni 2 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i papërditësuar, parashikon:
“Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Aksion" është titull pronësie që përfaqëson njëren nga pjesët në të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime.
2. "Likuiditete" janë mjetet monetare, të vendosura në *cash*, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe huadhënie.
3. "Pasuri e luajtshme e regjistruar" është çdo pasuri që nuk përfshihet në pasuritë e paluajtshme, e detyrueshme për t'u regjistruar në regjistrat publikë.
4. "Persona të lidhur" janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të cilët, nga kërkimet administrative, rezultojnë të kenë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklaram, në njëren nga format e përcaktuara në këtë ligj.
5. "Pjesë e kapitalit" është pjesa që zotëron një ortak në kapitalin e shoqërisë.
6. "Transaksion" është veprimi me anë të të cilit sigurohet kalimi i të drejtave dhe detyrimeve pronësore nga njëri pronar te tjetri.”
Kuptohet se subjekti Xhoxhaj, në përputhje me nenin 21, paragrafi 2 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ka pasur detyrimin të deklarojë edhe për personin e lidhur, {***}, si për faktin se ka rezultuar të ketë pasur lidhje pasurore para vitit 2005 me të, por edhe për faktin se më datë 04.03.2004, subjekti dhe personi i lidhur janë shtuar me fëmijë, çka presupozon edhe lidhjen e posaçme mes tyre.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaku i mësipërm i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar në argumente ligjore.

63. Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur ligjin gjatë procesit të rivlerësimit për kufizimin e deklarimeve vetëm te personat e lidhur, sipas përkufizimit përkatës të ligjit nr. 84/2016, duke shkelur të drejtat e personave të lidhur sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, familjarë të subjektit, por që për efekte të këtij ligji nuk konsiderohen persona të lidhur.
64. Trupi gjykues thekson se në ligjin nr. 84/2016, neni 3, pika 14 parashikohet rrethi i personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Nga ky përkufizim i përmbledhur, del qartë që nuk përjashtohen familjarët të cilët nuk janë të përfshirë në certifikatën familjare, por që mund të kenë interesa pasurorë apo lidhje afektive me subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, sipas nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin që të paraqesin të gjithë dokumentacionin që justifikon vërtetësinë e deklarimeve, por edhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tyre.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaku ligjor i mësipërm, i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i bazuar.

65. Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur standardet kushtetuese, ligjore dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt, pasi gjatë procesit Komisioni ka shkelur ligjin apo ka zbatuar keq ligjin në lidhje me moskonsiderimin e provave të dorëzuara ne Komision.
66. Trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim të ankueses, nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, konstaton se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar të drejtat dhe liritë themelore për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht, vërtetohet se subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, në Komision i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e saj të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi i është komunikuar publikisht, duke i dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitohet prova. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni me të drejtë i ka marrë në konsideratë provat dhe i ka vlerësuar sipas bindjes së tij për vlerën e tyre provuese.

Prandaj, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe pretendimi i mësipërm i ankueses nuk qëndron.

V. Shkaqet ankimore në lidhje me pasuritë

Shkaqet ankimore në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 1 dhe analizimi i tyre

67. Apartament banimi me sipërfaqe të shfrytëzueshme 101 m², plus 10 m² sipërfaqe e përbashkët dhe në total pasuri me sipërfaqe 111 m², ndodhur në adresën: Bulevardi Zogu i Parë, numër pasurie {***}, kati {***}, nr. {***}, Tiranë, pjesa takuese 50% e subjektit të rivlerësimit Altina Xhoxhaj, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 488 rep., nr. 69 kol., datë 08.03.2005 lidhur para noterit publik {***}, blerë në vlerën 61.050 euro, në bashkëpronësi me personin e lidhur {***} me pjesë takuese 50%, regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, me kontratën e shitjes nr. 2908 rep. dhe nr. 629 kol., datë 07.12.2011, lidhur para noterit publik {***}.

Burimi i deklaruar: Subjekti ka deklaruar se burimi i blerjes së pasurisë është nga puna dhe bursa e bashkëjetuesit në Itali, në vitet 1992-2001.

Rezultate të Komisionit në përfundim të hetimit kryesisht:

- *Ka mospërputhje të deklaramëve për burimin e të ardhurave, midis deklaratës së interesave privatë të personit të lidhur në vitin 2005, deklaratës “vetting”, si dhe origjinës së krijimit të kësaj pasurie (kontrata e sipërmarrjes nr. 115, datë 31.03.2003).*

- *Ka mungesë burimi financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, duke iu referuar deklaratës “vetting”.*

68. Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni në rezultatet e hetimit arsyeton: a) mungesë dokumentacioni; b) deklaram të rremë; c) fshehje të të ardhurave.

Rezulton se subjekti në deklaratën “vetting” shkruan se burimi i kësaj pasurie është bursa 1992-2001, ndërsa bashkëjetuesi nuk e ka deklaruar në pjesën e tij të deklaratës së interesave privatë. Rezulton deklarami i së njëjtës pasuri me burime të ndryshme nga subjekti dhe bashkëjetuesi në vitet 2003, 2005 dhe në deklaratën “vetting”. Me deklaratën noteriale nr. 480 rep., nr. 67 kol., datë 07.03.2005, personi i lidhur {***} deklaroi se është likuiduar në shumën 56000 euro nga {***}, si dhe kalimin e të gjitha të drejtave reale të pronësisë së apartamentit. Kjo deklaram noteriale diktoi ekzistencën e një kontrate sipërmarrjeje me nr. 479 rep., nr. 66 kol., datë 07.03.2005. Si subjekti, ashtu edhe bashkëjetuesi kanë rënë dakord që apartamentin 93 m² t’ia kalojnë {***} me kontratën e sipërmarrjes nr. 479 rep. dhe 66 kol., datë 07.03.2005. Në këtë kontratë rezultoi e cituar që të dy (subjekti dhe personi i lidhur) e kanë blerë me kontratën e sipërmarrjes nr. 115 rep., nr. 17 kol., datë 31.03.2003, kontratë e cila nuk është gjetur nga kërkimet e Komisionit dhe as sjellë nga subjekti. Veprimet noteriale që kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë *vetting* janë formalizuar me kontrata sipërmarrjeje, por që në thelb kanë pasur qëllim blerje e shitje të pasurisë. Pasuria *vetting* e ka burimin nga një apartament banimi me sipërfaqe 93 m², blerë në bashkëpronësi të Altina Xhoxhajt dhe {***}, në shumën 41.850 \$, me kontratën nr. 115 rep., nr. 17 kol., datë 31.03.2003.

Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar vendimin me shkaqet si më poshtë, në lidhje me pasurinë nr. 1 (101 m²)

69. Pasuritë janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe të qartë në deklaratën “vetting” dhe raporti i ILDKPKI-së ka rezultuar: a) deklarami është i saktë, në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklaram të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatë të konfliktit të interesit. ILDKPKI-ja është organ i specializuar për administrimin e deklaramëve të pasurisë dhe kontrollit ndaj tyre.

Trupi gjykues është shprehur në paragrafin 60 të arsyetimit të këtij vendimi në lidhje me këtë pretendim të ankueses.

70. Subjekti pretendon se në vendimin nr. 17 të Komisionit, shumica barazon termin “pasuri” me “veprimin juridik”, duke shkelur haptazi nenin 3, paragrafi 11 i ligjit nr. 84/2016, si dhe ligjin nr. 9049/2003 në kohën kur ka hyrë në fuqi, si rrjedhojë subjekti nuk kishte asnjë detyrim ligjor të deklaronte veprimet juridike të cilat kishte marrë pjesë, por që nuk kishin asnjë ndikim në shtimin apo pakësimin e pasurisë. Për pasojë, subjekti nuk kishte nënshkruar asnjë kontratë shitblerje pasurie gjatë vitit 2003 që të fitonte të drejta pasurore. Ndaj shumica në vendim, duke mos bërë dallimin e veprimit juridik me pasurinë, i kanë vendosur detyrimin për deklaramin e veprimit juridik, kur një gjë e tillë nuk ekzistonte as në vitin 2003. Në këtë pikë, nuk mund të flitet për shitje apo kalim pronësie, pasi personi i lidhur nuk ka pasur asnjëherë të drejta pronësie mbi këtë apartament dhe nuk mund të kalonte të drejta që nuk i kishte.

71. Trupi gjykues, në lidhje me pretendimin e mësipërm, arsyeton se kontrata e sipërmarrjes është një marrëveshje, e cila si shkak kryesor ka kryerjen e një vepre (punë) nga njëra palë, firma e ndërtimit “{***}”, dhe që në rastin konkret është një pallat banimi dhe pagimin e çmimit të apartamentit të këtij pallati nga pala tjetër, që janë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Kontrata e sipërmarrjes është njëkohësisht edhe një veprim juridik me anë të të cilit subjekti i rivlerësimit ka fituar të drejta reale mbi apartamentet objekte të kontratave.
72. Legjislacioni civil ka parashikuar si një ndër burimet e lindjes së të drejtave dhe detyrimeve përveç ligjit, edhe kontratat. Në të njëjtën kohë, kontrata si veprim juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, nuk është vetëm burim detyrimi, por kontrata është edhe një nga mënyrat e fitimit të pronësisë apo të të drejtave reale mbi sendet objekt i këtyre kontratave.
73. Arsyetimi i subjektit se Komisioni barazon veprimin juridik me pasurinë nuk qëndron si shkak për të cenuar në thelb vendimin e Komisionit, pasi në këtë rast Komisioni ka konstatuar/gjetur veprime juridike të dyanshme, të cilat në themel të tyre kanë vullnetin e personave që i kanë nënshkruar, nëpërmjet të cilave janë transferuar të drejtat reale mbi sendin objekt i veprimit juridik, kundrejt çmimit të përcaktuar. Për trupin gjykues, duke qenë se pronësia mbi sendet ka tri elemente kumulative që janë: posedimi, disponimi dhe gëzimi, dhe secili prej tyre më vete është një e drejtë reale mbi sendin, disponimin që në rastin konkret është transferuar, me transaksion nëpërmjet veprimeve juridike kontratave të sipërmarrjes, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, me të drejtë Komisioni e ka vlerësuar si një detyrim që ka pasur subjekti i rivlerësimit për t’u deklaruar sipas kërkesave të ligjit.

Prandaj, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe pretendimi i mësipërm i ankueses nuk qëndron.

74. Subjekti pretendon se nuk ka pasur në asnjë rast interesa pasurore, pasi ajo çka konsiderohet pasuri sipas neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, është çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme brenda dhe jashtë territorit shqiptar, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049 i ndryshuar, ndaj këtu nuk hyjnë veprimet juridike dhe një gjë e tillë nuk ishte e parashikuar as në vitin 2003 dhe as sot në vitin 2018.
75. Neni 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij”. Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “E drejta e pronës private është e garantuar. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil”. Neni 164 i Kodit Civil: “Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre”.
- Në nenin 79 të Kodit Civil është parashikuar shprehimisht: "Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile".
- Në nenin 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikohet të deklarohen pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil.
- Në rastin konkret, kemi një kontratë sipërmarrjeje që është veprim juridik i dyanshëm, ku palët që e kanë nënshkruar kanë shprehur vullnetin e tyre, duke përcaktuar objektin e kontratës si dhe çmimin që do të paguhet dhe që është paguar në rastin konkret.
76. Subjekti pretendon se veprimet juridike, si deklarata noteriale e datës 07.03.2005 për likuidimin e shumës 56.000 euro nga {***}, ashtu edhe kontrata e sipërmarrjes për porositjen e

apartamentit objekt shqyrtimi, janë nënshkruar nga bashkëjetuesi, sepse ka qenë pikërisht ai që ka bërë shlyerjen e apartamentit 1+1 në vitin 2003.

77. Deklarata noteriale me nr. 480 rep. dhe nr. 67 kol., datë 07.03.2005, është nënshkruar nga personi i lidhur {***}, sa për të dokumentuar që është bërë pagesa, meqenëse është bërë jashtë sistemit bankar. Ndërkohë, kontrata e sipërmarrjes për porositjen e apartamentit me nr.115 rep. dhe nr.17 kol., datë 31.03.2003, përmendet në kontratën e sipërmarrjes me nr. 479 rep. dhe nr. 66 kol, datë 07.03.2005, ku parashikohet: “Shoqëria e ndërtimit “{***}” SHPK ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje nr. 115 rep., nr. 17 kol., datë 31.03.2003, me Altina Xhoxhaj dhe {***} [...]”, duke përcaktuar edhe detaje të tjera të pronës.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata është nënshkruar vetëm nga personi i lidhur, nuk është i vërtetë, pasi edhe vetë subjekti rezulton nënshkruese në kontratë.

78. Subjekti pretendon se personi i lidhur ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të shlyer apartamentin 1+1, sepse i ka nga puna e tij dhe bursa në Itali për periudhën 1992-2001.
79. Nga analiza ekonomike, duke i përllogaritur këto periudha në raport me dokumentacionin e sjellë në Kolegj, pasi një pjesë të punës personi i lidhur e ka deklaruar në të zezë, rezulton se nuk janë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar pasuri në vlerat që pretendohet në ankim. Përllogaritjet janë kryer duke u bazuar në mandatpagesat e bankave dhe listëpagesat e kompanisë “{***}”, si dhe dokumentacionin justifikues të paraqitur nga Universiteti i Sienës për akordimin e bursave së personit të lidhur. Në vlerësimin e trupit gjykues, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe vetë subjekti nuk kanë provuar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave të tyre për periudhën 1992-2001, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe pretendimi i mësipërm i ankueses nuk qëndron.

80. Subjekti pretendon se për personin e lidhur, i cili ka qenë student gjatë periudhës shtator 1992 - korrik 1995, është marrë në konsideratë standardi i një studenti italian, por jo standardi i një studenti të huaj, në kuptimin që i janë përllogaritur më shumë shpenzime nga sa mund të ketë kryer.
81. Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin. Një ndër arsyet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë qenies në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti. Çmimet e të mirave dhe shërbimeve në shtetin italian kanë qenë të njëjta për të gjithë studentët, pavarësisht kombësisë. Përllogaritja e bursës bëhet duke u nisur nga disa tregues ekonomikë të vendit tek i cili do të bëhen shpenzimet, pa përcaktuar përkatësinë e kombësisë së studentit në raport me këto shpenzime.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit që përllogaritjet për shpenzimet e kryera të personit të lidhur në periudhën 1992-1995 i janë bërë sipas standardit të një studenti italian, nuk është i drejtë.

82. Subjekti pretendon se qenia në marrëdhënie pune e personit të lidhur për vitet 1995-2000, provohet me kontratën e punës me shoqërinë {***}- Itali, si dhe listëpagesat dhe dokumentet bankare të derdhjeve të pagës në llogari.
83. Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në pikën 21 të tij parashikon: “Deklarimi, si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të

shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”.

84. Nuk rezulton që të jetë e provuar shuma ose të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga emigracioni, përveç pagesave të bursës, të cilat nuk janë provuar me dokumentacion justifikues për një periudhë janar-korrik 1995, si dhe transfertat bankare për pagesat e shoqërisë {***}. Nga aktet e administruara në fashikull nuk rezultojnë të jenë provuar të ardhura të tjera të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrime tatimore në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 19, neni 3 i ligjit nr. 84/2016, të cilat, ashtu siç edhe subjekti sqaron, janë realizuar në të zezë. Për më tepër, trupi gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi e provuar se si janë transferuar këto kursime në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në pikën 21 të Udhëzimit të sipërcituar të ILDKPKI-së. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit, në bazë të dokumentacionit të administruar në dosje, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ishte në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar zhdukjen apo humbjen e dokumentacionit justifikues për të ardhurat e ligjshme, sipas pretendimeve të ankueses.

Kështu, sa i përket burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës ato mbesin në nivel deklarativ dhe nuk justifikohet ligjshmëria e tyre nga ana e subjektit të rivlerësimit.

85. Nga analiza ekonomike konstatohet se po t'u referoheshim të gjitha deklaramive që ka bërë personi i lidhur, duke marrë për bazë të gjitha të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën e jetesës në Itali të personit të lidhur, nuk mund të kursente më shumë se 850.000 lekë, shumë kjo e cila është e pamjaftueshme për të blerë apartamentin e pretenduar, të realizuar me këto të ardhura. Njëkohësisht, nga ana tjetër, edhe vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, nuk ka pasur mjete të mjaftueshme për të kontribuar në blerjen e pasurisë, për sa kohë është nënshkruese e kontratës së sipërmarrjes nr. 115 kol., nr. 17 rep., datë 31.03.2003. Ndryshe nga sa përmban kontrata e sipërmarrjes, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën dhe ta godasë vlerën provuese të saj, e cila ndodh vetëm në rastet e falsitetit. Subjekti gjithashtu nuk e ka kundërshtuar kontratën e sipërmarrjes as me ndonjë provë që do të provonte në mënyrë të pakontestueshme pagimin e vlerës së pasurisë nga personi i lidhur; për këtë arsye, trupi gjykues në vlerësimin e tij i referohet çka provon përmbajtja e kësaj kontrate sipërmarrjeje, që të çon në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaramit të rremë për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016

Përfundimisht, në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 1, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit konstaton se, nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore të pasurisë nr. 1, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, ka mungesë burimi financiar për të blerë pasurinë me vlerë 61.050 euro me të ardhurat e ligjshme të deklaruara dhe të ardhurat e ligjshme të provuara prej tij dhe personit të lidhur me të. Për këtë arsye, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të rremë, si dhe bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, ka kryer fshehje pasurie.

Shkaqet ankimore në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 2 dhe analizimi i tyre

86. Apartament 2+1 me sip. 58,75 m², pjesë takuese 50% në {***}, Durrës.
Fituar me kontratën e sipërmarrjes datë 05.10.2010, në vlerën 5.100.000 lekë.
Burimi i deklaruar nga subjekti: të ardhurat nga kursimet në vite.

Rezultatet e Komisionit: *Subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme* në vlerë 450.000 lekë për krijimin e pasurisë.

- Deklarata e vitit 2005 rezulton me 0 likuiditet.
- Sipas deklarimeve të viteve 2006, 2007, 2008, 2009, subjekti ka pasur likuiditete në vlerën 1.800.000 lekë.
- Sipas kontratës së sipërmarrjes, janë arkëtuar 4.500.000 lekë të parapaguara.
- Sipas deklaramit me *e-mail* të subjektit, ai ka paguar gjysmën e shumës, d.m.th. 2.250.000 lekë.

87. Subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme në vlerë 450.000 lekë, 2.250.000 lekë (gjysma e llogaritur nga Komisioni) -1.800.000 lekë (likuiditete të subjektit) diferenca rezulton 450.000 lekë, për krijimin e pasurisë. Megjithëse subjekti i rivlerësimit pretendon se ka të ardhura që nga viti 1994, ato janë pasqyruar në deklarin e parë në vitin 2003. Duke vlerësuar edhe të ardhurat e familjarëve në deklarin e vitit 2004, të babait të tij, të gjitha kursimet kanë shkuar për ndërtimin e shtëpisë së nënës së subjektit në {***}, Bathore. Me këtë arsytim, subjekti i rivlerësimit ka ardhur me zero likuiditete në vitin 2005. Po ashtu, i janë marrë në konsideratë paga e vitit 2009, si dhe të ardhurat nga shitja e makinës në vitin 2010. Nga deklarin e subjektit pretendohet se në vitin 2003 nuk kishin detyrim të deklaronin gjendjen *cash*, gjë që në shkresën e saj me nr. 1727 prot., datë 16.04.2018, ILDKPKI-ja ka qartësuar se një detyrim i tillë ka lindur që me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
88. Subjekti pretendon se duke bashkëjetuar me personin e lidhur, kanë pasur ekonomi të përbashkët dhe jo të karakterizuar nga mosmarrëveshjet, ndaj është e vështirë të thuhet se sa ka qenë kontributi i njërit apo i tjetrit, duke i sugjeruar Komisionit që ta ngarkojnë me masën 50% kontribut, pasi është e vetmja pasuri në të cilën ka arritur të kontribuojë me të ardhurat e tij. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit pretendon se jo çdo shpenzim dhe çdo likuidim është kryer në masën 50%.
89. Në nenin 163 të Kodit të Familjes parashikohet kuptimi i bashkëjetesës: “Bashkëjetesa është një bashkim fakti i burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”. Edhe në rastin konkret të subjektit, kemi prezent një bashkëjetesë të gjatë me personin e lidhur, me karakter stabiliteti, nga e cila kanë lindur edhe dy fëmijë. Në nenin 164 të Kodit të Familjes parashikohet: “Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës”. Nisur nga përcaktimi i këtij neni, bashkëjetuesit, nëse vendosin të ndajnë kufijtë e shpenzimeve dhe fitimeve, mund të lidhin marrëveshjen e cila i detajon dhe i përcakton këto ndarje gjatë jetesës së përbashkët. Në rastin konkret, nuk rezulton asnjë marrëveshje e tillë për ndarjen e detyrimeve dhe fitimeve gjatë bashkëjetesës, ndaj ekziston mundësia objektive dhe logjike që nga një marrëdhënie që karakterizohet nga stabiliteti dhe vazhdueshmëria e zhveshur nga mosmarrëveshjet, të kenë kontribuar në një raport të ndryshëm nga ai 50% me 50%, për sa kohë kanë edhe dy fëmijë nga kjo bashkëjetesë dhe nuk gjejmë një marrëveshje të firmosur që bën ndarjen sipas parashikimeve të përcaktuara në të.
90. Komisioni ka konstatuar se subjekti Xhoxhaj ka deklaruar me *e-mail* se kontributi i saj për këtë pasuri ka qenë në masën 2.250.000, që rezulton gjysma e shumës së parapaguar sipas kështit të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, datë 05.10.2010.
91. Në *e-mail*-in e datës 19.02.2018, subjekti i është përgjigjur Komisionit, duke deklaruar se e ka të vështirë të përcaktojë me saktësi sa ka kontribuar vetë dhe sa personi i lidhur, pasi nuk kanë pasur mosmarrëveshje që të ndanin pjesët e kontributit, por, duke qenë e vetmja pronë që ka arritur të investojë mund të përllogaritet me 50% në ngarkim të saj, por kurrsesi subjekti nuk ka deklaruar shumën e saktë sa ka paguar për kështin e kësaj pasurie. Edhe sikur të përllogariten

me 50% kontribut, nga relacioni ekonomik diferenca është në shumën +3.083 lekë dhe jo sa pretendon Komisioni në shumën -450.000 lekë.

92. Trupit gjykues i rezultoi se nuk ekziston asnjë diferencë për të pretenduar të ardhura të pamjaftueshme për të blerë apartamentin, për më tepër që ndarja e shpenzimeve me bashkëjetuesin ndryshon edhe situatën e përllogaritjes së shpenzimeve.
93. Sa i takon pasurisë apartament 2+1 me sipërfaqe 58,75 m², pjesë takuese 50% në {***}, Durrës, duke mbartur edhe likuiditetet e një viti më parë, pra vitit 2009 të deklaruara në deklarin periodik të pasurisë, nuk rezulton se ka të ardhura të pamjaftueshme për krijimin e saj, për sa kohë ka qenë në një bashkëjetesë ku nuk mund të ndahen me saktësi pjesët takuese të gjithsecilit, madje edhe shpenzimet janë të përbashkëta. Për Kolegjin është pranuar fakti i një ekonomie të përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të gjatë kësaj periudhe, prandaj edhe analiza financiare rezulton me një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni.

*Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në lidhje me pasurinë apartament 2+1 me sipërfaqe 58,75 m², pjesë takuese 50% në {***}, Durrës, konstaton se pretendimi i subjektit është i bazuar, pasi në këtë rast nuk jemi përpara situatës së pamjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.*

Shkaqet ankimore në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 3 dhe analizimi i tyre

94. Truall me sipërfaqe 221,9 m² (kalim i së drejtës mbi truallin e njësisë së ndërtuar) me pjesë takuese 50%, në shumën 411.249 lekë, fituar me kontratën nr. 2184 rep. dhe 1140/1 kol., datë 26.09.2013, i ndodhur në {***}, Durrës.
Rezultatet e Komisionit: *Subjekti ka përfituar sipërfaqe të tepërt trualli, veprim që e rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit.*
Arsyetimi ligjor i Komisionit: Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka marrë më shumë nga sa i takonte nga ligji dhe VKM-ja.
Lidhur me këtë pasuri nuk rezulton asnjë përpjekje e subjektit për të kuptuar pse i ka takuar kaq shumë truall, që subjekti e justifikon me sipërfaqen që zë njolla e apartamentit.
95. Subjekti pretendon dhe rezulton e provuar me kërkesën (formular tip) drejtuar ALUIZNI-t më datë 08.10.2010, nga subjekti Xhoxhaj dhe personi i lidhur, se sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë është 50 m² (vetëm njolla nën apartament). Me këtë kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, është vënë në lëvizje ALUIZNI duke përgatitur dokumentacionin për dhënie trualli në pronësi.
96. ALUIZNI, menjëherë pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e kërkuesve, ka bërë përllogaritjet për të nxjerrë vlerën e tarifës së shërbimit për përditësim (6.656 lekë), si dhe vlerën e parcelës ndërtimore (411.249 lekë), të dy këta janë formularë tip që mbajnë të njëjtin numër 2863 dhe të njëjtën datë 16.09.2013. Pas 7 ditësh janë paguar nga kërkuesit shumat e përcaktuara në faturë, sipas përllogaritjeve të kryera nga ALUIZNI, duke përfituar edhe një zbritje sipas ligjit me 20% në vlerën e parcelës ndërtimore, nëse paguhen brenda një muaji nga njoftimi i vlerës së faturës. Trualli i cili do të jepej në pronësi, sipas llogaritjeve të kryera nga ALUIZNI, ka një sipërfaqe prej 221,9 m², i cili i jepet subjektit dhe personit të lidhur edhe pse kanë kërkuar vetëm 50 m², që përbën njollën e apartamentit përkatës.
97. Me shkresën nr. 1229/1 prot., datë 05.03.2018, ALUIZNI me kërkesën e Komisionit ka dërguar metodikën e përllogaritjes së sipërfaqes takuese duke treguar edhe formulën e përdorur, bazuar në të dhënat e sipërfaqes së parcelës, sipërfaqes totale ndërtimore, si dhe sipërfaqes së apartamentit të kërkuesve (subjekti i rivlerësimit + personi i lidhur). Nga kjo përllogaritje e formulës, rezulton se sipërfaqja takuese duhet të ishte 122,89 m² dhe jo sipërfaqja prej 221,9

m² për të cilën është dhënë nga ALUIZNI leja e legalizimit në vitin 2013. Këtë sipërfaqe të përfituar (221,9 m²) nuk është në gjendje ta shpjegojë as vetë institucioni (ALUIZNI) përgjegjës dhe kompetent, i cili me dokumente shkresore ka përllogaritur metrat katrorë të sipërfaqes takuese duke u bazuar në formulat përkatëse të legjislacionit në fuqi.

98. Pra, kemi një situatë të tillë ku subjekti ka kërkuar një sipërfaqe prej 50 m², duke iu referuar njollës së apartamentit pa sipërfaqet e përbashkëta. Ndërkohë ekziston një formulë sipas shkresës së ALUIZNI-t, përllogaritja e saktë e së cilës e nxjerr sipërfaqen takuese 122,89 m², ndërsa sipas përllogaritjes që ka bërë AUIZNI rezulton 221,9 m² për të cilat është realizuar pagesa. Pra subjekti nuk e dinte formulën e përllogaritjes, pasi ka kërkuar edhe më pak metra seç i takojnë. Në momentin që institucioni kompetent i ka dërguar faturën, subjekti e ka paguar. Për më tepër subjekti nuk ka kryer asnjë veprim konkret të posaçëm për të përfituar sipërfaqe më tepër dhe se e gjitha ka qene një vlerësim apo llogaritje e institucionit përkatës.

Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sa i përket kësaj pasurie, nr. 3, duke u bazuar edhe në provat shkresore që gjenden në dosje, e gjen pretendimin e subjektit të rivlerësimit të bazuar, ndaj në rastin konkret, rezultati i Komisionit, nëpërmjet të cilit, me veprimet e kryera, rëndohet pozita e subjektit, nuk është i bazuar në ligj dhe nuk qëndron.

Shkaqet ankimore në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 4 (likuiditete) dhe analizimi i tyre

99. Likuiditete të subjektit në shumën prej 6300000 lekësh, dhe të personit të lidhur prej 61484 dollarësh amerikanë dhe 15000 eurosh.

Burimi i deklaruar:

1. Nga subjekti: kursimet nga pagat dhe trajnimet ndër vite.
2. Nga personi i lidhur: kursimet nga të ardhurat ndër vite dhe pagat, honorarët/dietat në misione vëzhgimi në OSCE, ODIHR dhe qira apartamenti.

Rezultate të Komisionit: *Nga analiza e të dhënave për vitet 2007, 2009, 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit të ligjshëm financiar për të justifikuar shumën 1.972.969 lekë.*

- Për vitin 2007, ka më shumë se çfarë i rezulton për vete dhe për bashkëjetuesin.
- Për vitin 2009, ka bërë udhëtime me shpenzimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD) dhe Komisioni sipas pretendimeve të subjektit ka bërë një mbivlerësim në vlerën 277.796 lekë.

Arsyetimi ligjor i Komisionit:

- *Subjekti ka mungesë të burimit të ligjshëm financiar për të justifikuar shumën prej 1.972.969 lekësh.*
- *Në lidhje me deklarimin e gjendjes cash prej 15.000 eurosh të personit të lidhur, Komisioni çmon se bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 9049/2003.*

100. Subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë abuzive, edhe pse rëndonte me barrë prove, nuk merrte parasysh provat (saktësisht deklaratën noteriale të datës 31.03.2018 për të provuar qëndrimin të miqtë e tij në ShBA, si dhe dokumentin e spitalit të datës 11.07.2007 për të provuar se ishte përfshirë në programin e ndihmës ekonomike për lindjen e fëmijës), duke arsyetuar se janë hartuar gjatë hetimit administrativ. Si rrjedhojë, i janë përllogaritur edhe shpenzime udhëtimi për këtë periudhë. Vlen të theksohet që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë pretendim, në asnjë moment në Komision (pas komunikimit të rezultateve të hetimeve paraprake, si dhe në seancë dëgjimore) apo edhe në ankimin në Kolegj lidhur me metodologjinë e ndjekur nga Komisioni për përllogaritjen e likuiditeteve të saj, duke përfshirë këtu mungesë pretendimesh prej saj për standardin e përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës,

shpenzimeve të udhëtimit etj., përveç atyre të cilat janë trajtuar në mënyrë të posaçme me poshtë në këtë vendim të trupit gjykues.

101. Sa i përket deklaratës noteriale të datës 31.03.2018, të dhënë nga shtetasit {***} dhe {***}, përpara noterit publik {***}, në shtetin e New York-ut, të dorëzuar nga subjekti, nuk është pranuar nga Komisioni me arsyetimin se është deklaratë e përpiluar gjatë hetimit administrativ. Këto prova jo domosdoshmërisht duhet të jenë përpiluar në kohën reale kur ka ndodhur ngjarja, që të kenë vlerë prove dhe të pranohen si të tilla. Rregullat për marrjen e provës janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile dhe ndryshojnë në varësi të llojit të provës. Në rastin e deklaratës noteriale, kemi të bëjmë me një akt zyrtar (neni 253 i Kodit të Procedurës Civile.), që përpilohet nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë para tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre. Nga përmbajtja e nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, del qartë që një element i rëndësishëm është forma e caktuar e aktit. Konkretisht, kemi një deklaratë noteriale të përpiluar në gjuhën shqipe përpara noterit me shtetësi amerikane (jo shqiptar) në New York. Nuk rezulton e pasqyruar në deklaratë të jetë prezent një përkthyes i gjuhës shqipe, ose që vetë noteri të ketë njohuri të gjuhës shqipe. Pra, nuk është e qartë nga kush është përpiluar deklarata. Gjithashtu, një akt zyrtar i huaj, që të përdoret në vendin tonë, duhet të legalizohet ose nga ambasada shqiptare në shtetin e huaj, ose të vuloset me vulë apostile. Në rastin konkret, një dokument i lëshuar në ShBA dhe që do të përdoret në Shqipëri, duhet të certifikohet me një vulë apostile nga autoriteti lëshues, për shkak të qenies palë në Konventën e Hagës së datës 5 tetor 1961 për heqjen e legalizimit të dokumenteve të huaja publike. Pra, deklarata noteriale nuk ka elemente të tilla, të domosdoshme për vlefshmërinë e një dokumenti të huaj në territorin tonë, ndaj nuk duhet pranuar si provë për shkak të mangësive në formë.

102. Subjekti pretendon se udhëtimin e datës 08.02.2007 në Vjenë, nuk e mban mend me saktësi se për se është kryer, por fakti që është vetëm 4 ditë, duhet të prezumohet se ka qenë për shkak të funksionit në KLD, ndaj nuk duhet t'i ishlin llogaritur shpenzime.

Duke qenë se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë në lidhje me mbulimin e shpenzimeve për këtë udhëtim, as nga KLD-ja dhe as nga Gjykata e Tiranës, në një kohë që KLD-ja ka lëshuar vërtetime edhe në vitin 2018 për udhëtime të viteve të mëparshme, nuk mund të prezumohet se janë hequr shpenzimet nga KLD-ja vetëm se udhëtimi ka qenë 4-ditor dhe pa familjarët.

Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sa i përket këtij pretendimi, çmon se subjekti nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të shpenzimeve për këtë rast.

103. Subjekti gjithashtu pretendon se në udhëtimin e datës 01.04.2007, vizitë në Këshillin e Magjistraturës në Romë, të kryer në kuadër të binjakëzimit me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, nuk disponon dokumentacion justifikues për shpenzimet e udhëtimit, pasi KLD-ja në shkresën me nr. 1044/1 prot., datë 03.04.2018, sqaron se në kuadrin e binjakëzimeve apo vizitave studimore të zhvilluara gjatë viteve 2006-2010, nuk disponojnë dokumentacion, sepse ato financoheshin nga BE-ja, Këshilli i Evropës, Euralius ose institucione të tjera homologe.

104. Ky vërtetim, i sjellë nga KLD-ja, nuk është pranuar për të zbritur shpenzimet, pasi nuk sqaron se pikërisht ky udhëtim është financuar nga ndërkombëtarët homologë. KLD-ja tregon periudhën të cilën nuk e ka financuar vetë, por kjo nuk prezumon se çdo udhëtim i kryer gjatë kësaj kohe është financuar nga të huajt dhe nuk do të llogaritet shpenzimi.

Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sa i përket këtij pretendimi, çmon se subjekti nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të shpenzimeve.

105. Subjekti pretendon se për udhëtimin e datës 26.03.2007, të personit të lidhur për arsye pune në Washington DC, si përfaqësues i Komisionit Qendror Zgjedhor, i është dërguar Komisionit urdhri i brendshëm i lëshuar nga titullari, ku provon se të gjitha shpenzimet janë përballuar nga institucioni dhe ky dokumentacion nuk është marrë parasysh nga Komisioni, duke i përlogaritur shpenzime.
106. Nga verifikimi i rezultateve ekonomike, nuk rezulton që ky udhëtim të jetë llogaritur në shpenzime nga Komisioni, *ndaj pretendimi i subjektit nuk është i saktë dhe është i pabazuar.*
107. Subjekti pretendon se gjendja *cash* prej 15000 eurosh, e mbajtur jashtë sistemit bankar nga personi i lidhur, ka ndodhur për shkak se ndodhej jashtë shteti për arsye pune në momentin që ka hyrë në fuqi ligji për deklarimin e gjendjes *cash*. Këto para i ka nga kursimet nga puna e ligjshme.
108. Rezulton që shuma *cash* prej 15000 eurosh e personit të lidhur, e mbajtur në banesë, është deklaruar në vitin 2016. Sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, varianti fillestar në nenin 4, germa “d”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKP *vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*. Sipas kësaj dispozite, personi i lidhur duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve në *cash* derisa të arrinte te shuma e sipërcituar. Ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2003 dhe personi i lidhur, edhe sikur të ishte jashtë shteti për arsye pune, mund ta deklaronte në deklaratat e tij të pasurisë si person që mbart detyrimin për deklarim.
109. Në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar me ligjin nr. 45/2014, në nenin 4, pika 1, parashikon: “Subjektet e këtij ligji, që plotësojnë deklarimin për herë të parë, sipas nenit 5/1 të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milionë lekë. Për subjektet që deklarojnë sipas nenit 5/1 të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI”.
110. Mbi sa më sipër, rezulton se paratë *cash* prej 15000 eurosh janë mbajtur në banesë të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, duke mos deklaruar gjendjen e *cash*-it vit pas viti, por e ka deklaruar të akumuluar në vitin 2016, gjithashtu në kundërshtim me po këtë ligj të ndryshuar në vitin 2014 për totalin prej 1,5 milionë lekësh, të mbajtura jashtë sistemit bankar.
- Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sa i përket këtij pretendimi dhe justifikimit të subjektit në këtë rast, vlerëson se janë të pasaktë dhe të pabazuar.*
111. Duke iu referuar analizës ekonomike, bazuar në shkaqet e ankimit të subjektit dhe në rezultatet ekonomike të Komisionit lidhur me likuiditetet për vitet 2007, 2009, 2015, 2016, kemi respektivisht këto rezultate:
- I. Për vitin 2007, në situatën financiare për subjektin dhe bashkëjetuesin e saj, kemi një diferencë të ndryshme nga ajo që i ka rezultuar Komisionit dhe pretenduar nga subjekti. Saktësisht, përlogaritja e likuiditeteve deri në fund të vitit 2006 dhe të ardhurat nga paga për të dy bashkëjetuesit, Altina Xhoxhaj dhe {***}, duke zbritur nga kjo shumë shpenzimet dhe gjendjen e likuiditetit të datës 31.12.2007, rezulton një diferencë negative në shumën 383.561,25 lekë. Kjo diferencë vjen e ndryshme nga Komisioni (-450097) për shkak se ky i fundit nuk ka përlogaritur shpenzimet reale të kredisë për vitin 2007, por ka përfshirë në këtë shumë edhe shlyerjet që u përkasin periudhave para vitit 2007. Në përlogaritjen e Kolegjit, në

zërin e shpenzimeve të kredisë janë ngarkuar vetëm shpenzimet e shlyerjes së kredisë për vitin 2007. Ndërsa vjen e ndryshme nga përllogaritjet e subjektit (+407.876) për shkak të llogaritjes së shpenzimeve të jetesës dhe të udhëtimeve më të vogla seç rezultojnë të provuara, ashtu sikundër disa shpenzime janë të paprovuara me prova shkresore nga subjekti.

II. Për vitin 2009, situata financiare për subjektin dhe bashkëjetuesin, rezulton përsëri me një diferencë të ndryshme nga ajo që ka rezultuar në Komision dhe është pretenduar nga subjekti. Saktësisht, përllogaritja e likuiditeteve deri në fund të vitit 2008, plus të ardhurat nga paga për të dy bashkëjetuesit, Altina Xhoxhaj dhe {***}, duke zbritur nga kjo shumë shpenzimet dhe gjendjen e likuiditetit të datës 31.12.2009, rezulton diferencë negative në shumën 85.458,45 lekë. Kjo diferencë vjen e ndryshme nga Komisioni (-965.119) për shkak se ky i fundit nuk ka përllogaritur të ardhurat e personit të lidhur nga misioni i OSBE/ODIR në shumën 8.711 euro. Ndërsa vjen e ndryshme nga përllogaritjet e subjektit (+205.183) për shkak të llogaritjes nga ana e tij më pak shpenzime për udhëtimet.

III. Për vitin 2015, situata financiare për subjektin dhe bashkëjetuesin rezulton me diferencë të ndryshme nga ajo që ka rezultuar në Komision dhe që ka pretenduar subjekti. Përllogaritja e likuiditeteve deri në fund të vitit 2014, plus të ardhurat nga paga për të dy bashkëjetuesit, Altina Xhoxhaj dhe {***}, duke zbritur nga kjo shumë shpenzimet dhe gjendjen e likuiditetit më datë 31.12.2015, kemi një diferencë negative në shumën 819.238,57 lekë. Kjo diferencë vjen e ndryshme nga Komisioni (-557.753) për shkak se ka shtim të depozitave nga subjekti dhe personi i lidhur, që është zbritur në përllogaritje nga gjendja e likuiditeteve jashtë sistemit bankar. Ndërsa nga llogaritjet e subjektit pretendohet diferencë pozitive (+437.017) për shkak të përllogaritjes më pak shpenzime udhëtimi.

IV. Rezultojnë gjithashtu në vitet 2015, 2016 depozita në dy banka në ShBA, si të subjektit ashtu dhe personit të lidhur, për të cilat nuk është e qartë se kur janë depozituar, si janë shtuar shumat monetare të këtyre depozitave, pasi nuk rezultojnë në deklaratimet periodike. Gjithashtu, nuk është sjellë nga subjekti asnjë dokument për të vërtetuar si janë transferuar këto shuma në ShBA, për krijimin e depozitave të deklaruara në deklaratën “vetting”. Janë sjellë nga subjekti vetëm gjendjet e llogarive për vitin 2016, ku në këto gjendje nuk verifikohet asnjë lëvizje e kryer me këto shuma vit pas viti. Subjekti ka deklaruar dhe pretenduar se nuk mund të tërhiqte nga banka gjendjet e llogarive që nga fillimi hapjes së tyre. Ndërkohë që në vlerësimin e trupit gjykues arsyetohet se zotëruesi i llogarisë bankare është klienti i bankës dhe banka vetëm e administron këtë llogari. Pra, subjekti i i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë të drejtën të kërkojnë çdo informacion nga banka për llogaritë që ata zotërojnë. Në këto kushte, ata kanë dështuar të provojnë bindshëm mënyrën se si këto depozita janë krijuar, si dhe çdo veprim të kryer prej tyre në to.

Për pasojë, sipas vlerësimit të trupit gjykues, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në këtë rast është i pabazuar në ligj.

Nga sa rezultoi e provuar dhe e analizuar për pasurinë nr. 4 (likuiditete), kemi një diferencë negative prej -1.288.258,27 lekësh, e cila është e ndryshme nga ajo që ka përllogaritur Komisioni (-1.972.969 lekë) për shkaqet e përmendura më lart. Për pasojë, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, konkludohet se subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre shumave monetare, përpiqet të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në likuiditete, si dhe ajo vetë dhe personi i lidhur me të nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për këto shuma monetare.

Shkaqet ankimore në lidhje me çështjen nr. 5 dhe analizimi i tyre

112. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 ka deklaruar: kredi në shumën 40000 dollarë amerikanë për blerjen e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 120 m², në adresën Bulevardi {***}, në shumën 54.000 dollarë amerikanë.

Burimi i krijimit: Përveç kredisë, edhe të ardhurat familjare.

Rezultatet e Komisionit: Veprimet e subjektit, në cilësinë e kredimarrëses, nuk përputhen me kohën e blerjes së kësaj pasurie për arsye se shlyerja e apartamentit të deklaruar si i blerë me këtë kredi (dhënë kredia në mars 2003), është shlyer përpara se të jepet kredia nga banka (shlyer shkurt 2003). Kontrata e paraqitur si provë për marrjen e kredisë mban datën 01.10.2007. Në kontratë citohet se shlyerja është bërë në dy këste, janar-shkurt 2003.

Arsyetimi ligjor i Komisionit: *Subjekti ka kryer fshehje të destinacionit të kredisë, veprimi është fiktiv, çka rëndon pozitën e subjektit.*

a) Komisionit nuk iu vu në dispozicion asnjë kontratë për të provuar disbursimin e kredisë.

b) Komisioni nuk mund të merrte në konsideratë deklaratën e shoqërisë ndërtimore “{***}”, me nr. 417, datë 05.04.2018, gjatë hetimit administrativ.

c) Në kontratën nr. 3957, datë 01.10.2007, nuk është pasqyruar mënyra e pagesës, por në të deklarohet që palët janë likuiduar jashtë kësaj zyre dhe duke parashikuar edhe këstet prej 30.000 dollarësh amerikanë dhe 24.450 dollarësh amerikanë.

Nga gjithë dokumentacioni i administruar, nuk provohet se për cilën pasuri është disbursuar kredia.

113. Subjekti pretendon se argumentimi i Komisionit që nuk ka asnjë dokumentacion për të provuar se për cilën pasuri është disbursuar kredia, është i pabazuar, pasi ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin që i përket kësaj kredie, me kontratën dhe mandatarkëtimet që i përkasin vlerës së apartamentit.

114. Nga provat në dosje rezulton se në datën 26.02.2003 është lidhur kontrata e kredisë mes palëve kontraktuese: Banka Kombëtare e Greqisë dhe subjektit Altina Xhoxhaj, me dorëzanës {***} dhe {***}. Shuma e kredituar nga kjo kredi është 40000 \$. Në nenin 2 të kësaj kontrate përcaktohet qëllimi i marrjes së kredisë, ku citohet se kredia i jepet kredimarrësit me qëllim blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës, në Bulevardin {***}, me sipërfaqe 121 m². Pas lidhjes së kontratës së kredisë, subjekti në datën 10.03.2003 ka hapur llogari në dollarë në të njëjtën bankë ku është lidhur kontrata e kredisë, nga ku shumën e disbursuar prej 40.000 dollarësh ia ka transferuar përfituesit “{***}” SHPK në Dardania Bank. Gjithashtu, në provat e sjella nga subjekti, rezulton edhe një mandatarkëtimi i datës 31.01.2003, ku {***} ka paguar shumën 14.000 \$, ku vihet re shënimi “lik. kësti ap.”, që kuptohet si likuidim kësti apartamenti. Personi i cili ka arkëtuar shumën ka nënshkrimin e njëjtë me personin që ka nënshkruar si e pranishme (ekonomistja {***}) në deklaratën noteriale me nr. 417 rep. dhe nr. 153/3 kol., të bërë para noterit nga {***} dhe {***}, administratori i shoqërisë “{***}” SHPK. Në datën 09.07.2007 është arkëtuar nga {***} shuma 450 \$, me shënimin “likuidim përfundimtar ap. 121 m², kat i katërt banimi”, ku tek arkëtari gjendet i njëjti nënshkrim me mandatarkëtimin tjetër, të vitit 2003.

115. Kemi një situatë të tillë ku rezulton e parapaguar shuma prej 14.000 \$ për apartamentin e sipërcituar. Nuk gjejmë në dosje dhe as pohohet nga subjekti të ketë pasur një kontratë sipërmarrjeje apo porosie me shoqërinë “{***}”. Konstatohet një kredi e disbursuar prej 40.000 dollarësh amerikanë për blerjen e këtij apartamenti të cilësuar në kontratë, të cilat i kanë kaluar shoqërisë “{***}”, si dhe një tjetër mandatarkëtimi prej 450 \$ në vitin 2007, të marra të gjitha

së bashku bëjnë shumën prej 54.450 \$, e cila përkon me vlerën e deklaruar nga subjekti për blerjen e apartamentit.

116. Më datë 01.10.2007, me kontratën nr. 3957 rep. dhe nr. 632 kol., lidhet kontrata e shitjes mes palës shitëse shoqëria “{***}” SHPK dhe palës blerëse {***}, me objekt shitje apartamentin me sipërfaqe 121 m². Në pikat e kësaj kontrate citohet se vlera e apartamentit është likuiduar jashtë kësaj zyre me këstin e parë prej 30.000 \$ në datën 24.01.2003 dhe këstin e dytë prej 24.450 \$ në datën 28.02.2003 dhe palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëra-tjetrës. Duke u nisur nga mënyra e pagesës së kësteve të cituara më sipër, e cila nuk përkon me mandatarkëtimet për këtë pasuri, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka kryer fshehje të destinacionit të kredisë, për shkak dhe se nuk rezulton një kontratë sipërmarrjeje apo porosie mbi të cilën është dhënë kredia.
117. Në kontratën e kredisë vërehet që kolateral është lënë një tjetër pronë, saktësisht prona me nr. {***}. Banka është mjaftuar me gjetjen e kolateralit dhe përshkrimin e pronës për të cilën do të disbursohet kredia, pa u ndalur në kontratë porosie apo sipërmarrjeje, pasi kontratë shitje nuk mund të kishte për sa kohë prona ishte ende e paregjistruar. Regjistrimi fillestar është bërë në datën 09.05.2007 nga shoqëria “{***}”, kjo e cituar edhe në kontratën e shitjes, si dhe e provuar me certifikatën e pronësisë nr. 101, datë 09.05.2007.
118. Duke qenë se të gjitha veprimet e kryera nga subjekti dhe babai i saj përputhen edhe me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe me deklaratimet e vitit 2003, trupi gjykues i Kolegjit çmon se nuk jemi përpara faktit të fshehjes së destinacionit të kredisë. Në kontratën e kredisë janë specifikuar të dhënat e apartamentit, po kështu edhe në mandatarkëtimet, si dhe shuma përkon me atë që është deklaruar, përveç kontratës së shitjes ku është dhënë e njëjta shumë blerjeje, por janë ndryshuar këstet.
119. Fakti që kredia është disbursuar pa një kontratë paraprake, mund të jetë realizuar në mirëbesim nga ana e bankës, pasi në vitin 2003 bankat nuk kishin politika kaq strikte sa sot. Ky fakt nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi ose të rëndojë pozitën e subjektit për aq kohë sa kemi përputhje të deklaratimeve, mandatarkëtimeve dhe disbursimit të kredisë duke përcaktuar në kontratë dhe qëllimin për të cilën është disbursuar. Pretendimi i subjektit është i bazuar në ligj dhe në prova në lidhje me çështjen nr. 5 për arsyet e sipërcituara.

Sa më sipër, përfundimi i Komisionit se kemi fshehje të destinacionit të kredisë, veprime fiktive të cilat rëndojnë pozitën e subjektit të rivlerësimit, për trupin gjykues të Kolegjit nuk është i bazuar.

Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 6 dhe analizimi i tyre

120. Tokë bujqësore me sipërfaqe 666 m² në fshatin {***}-Bathore, me ¼ pjesë takuese, vlera totale 500.000 lekë + banesë karabina filluar ndërtimi në vitin 2000 me pjesë takuese ¼, me vlerë 3 milionë lekë.

Burimi i krijimit i deklaruar: Për truallin burim janë të ardhura familjare, ndërsa për karabinanë të ardhura familjare nga shitja e banesës së privatizuar, në total 6.200.000 lekë.

Rezultatet e Komisionit:

1. Subjekti i deklaratimit në këtë vit ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me prindërit dhe motrën e saj.
2. Trualli dhe shtëpia e ndërtuar mbi të, me sipërfaqe 666 m² figurojnë në emër të nënës së subjektit, znj. {***}.
3. Subjekti e ka deklaruar truallin dhe godinën në deklaratat 2003 dhe 2004, por nuk është deklaruar në deklaratën “vetting” dhe pjesa takuese prej 1/4.

Arsyetimi ligjor i Komisionit: Për deklaratimet e bëra për truallin në Bathore dhe godinën mbi të, në të njëjtën pjesë takuese, në vitin 2003 dhe 2004, çmohet se subjekti i rivlerësimit *ka bërë deklaratim të pasaktë në raport me pjesën takuese me veprimet juridike.*

121. Subjekti pretendon se për pasurinë truall me sipërfaqe 666 m², e cila është në pronësi të nënës së saj, të cilën në deklaratat e vitit 2003 e ka deklaruar si pjesë takuese me 1/4, ka ardhur për shkak se ka jetuar me prindërit dhe motrën në të njëjtën përbërje familjare, si dhe duke iu referuar nenit 6 të ligjit 9049/2003 që kërkonte deklarinimin e të gjitha pasurive të akumuluar (sot i shfuqizuar), e ka bërë deklarinimin duke u nisur si pronë e përbashkët.
122. Rezulton se në vitet që ka bërë deklarinimin e truallit (2003-2004), subjekti ka qenë në përbërje familjare me prindërit dhe motrën e saj. Ndërkohë, në kontratën e shitblerjes me nr. 3515 rep. dhe 470 kol., datë 08.11.1999, pala blerëse është vetëm nëna e subjektit, {***}. Gjithashtu burimi i deklaruar për blerjen e truallit është me të ardhura familjare. Pra, kemi të bëjmë me një pasuri për blerjen e së cilës kanë kontribuar të gjithë familjarët, por që rezulton e regjistruar nga nëna e subjektit.
123. Rezulton që në deklaratën “vetting” nuk është deklaruar më kjo pjesë takuese nga subjekti. Gjithashtu, vetë subjekti pranon që kjo pasuri është e nënës së saj, por e ka deklaruar për efekt të jetesës së përbashkët, por me një pasaktësi duke deklaruar edhe pjesën takuese prej 1/4, në një kohë që subjekti nuk kishte titull pronësie, edhe pse mund të kishte kontribut në blerjen e këtij trualli.
124. Subjekti nuk përlligjet sipas nenit 6 të ligjit 9049/2003 të deklarojë pasuritë e akumuluar edhe nga pjesëtarët e familjes duke i pjesëtuar dhe përcaktuar pjesët takuese vetëm për efekt të të qenit në të njëjtën përbërje familjare, por kjo ka ndodhur në kuadër të një pasaktësie në deklaratim, pasi shihet edhe në vitin 2016 në deklaratën “vetting” nuk janë cituar këto pjesë takuese.

Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit vlerëson përfundimisht se subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë.

Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 7 dhe analizimi i tyre

125. Banesë karabina, ndërtim i filluar në vitin 2000, në pjesë takuese 1/4, me vlerë 3 milionë lekë në {***}, Bathore.
Burimi i deklaruar:
 1. Shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi masiv i banesave, në vlerën 6200000 lekë.
 2. 35000 \$ të ardhura nga shitja e këtij apartamenti/burimi i deklaruar i krijimit: nga shitja e banesës në rr. “{***}”, përfituar nga privatizimi masiv.

Rezultatet e Komisionit: *Ka mospërputhje të vlerave të deklaruara në deklaratën e vitit 2003 dhe pjesës takuese me veprimet juridike ku subjekti ka nënshkruar.*

Nisur nga kjo, subjekti ka deklaruar kontratën e shitjes së babait kundrejt të tretëve në shumën 5900.000 lekë, duke deklaruar 1/4 pjesë takuese, në një kohë që për këtë pasuri ka një veprim tjetër juridik të mëparshëm, kontrata nr. 595 rep., nr. 101 kol., datë 08.02.2003, që subjekti i rivlerësimit bashkë me 4 bashkëpronarë të tjerë ia kanë shitur këtë pronë babait të tij në vlerën 15 milionë, ku subjekti ka përfituar 300.000 lekë dhe ky veprim e ka zhveshur subjektin nga pronësia.

Arsyetimi ligjor i Komisionit: Nuk përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me kontratën nr. 595 rep., 101 kol., datë 08.02.2003, si pasojë *ka bërë deklaratim të rremë* sa i përket shumës së përfituar nga shitja e kësaj pasurie.

126. Subjekti i rivlerësimit pretendon se duke qenë në një përbërje familjare me babain, i cili ka qenë gjithashtu subjekt deklarimi, i ka plotësuar deklaratat e pasurisë në të njëjtën mënyrë si kryefamiljari, pasi ka vlerësuar se duhej të deklaronin të gjithë pasurinë e familjes, pra të çdo pjesëtari të saj dhe jo sepse ka pasur ndonjë pasuri më vete, të regjistruar në emrin e tij. Formularin e deklarimit të parë, thotë subjekti, e ka plotësuar nën udhëzimet e ILDKP-së së kohës, në mungesë të informacioneve dhe udhëzimeve institucionale se si duheshin plotësuar.
127. Deklarimet e subjektit në vitin 2003, lidhur me këtë pasuri, janë po në pjesë takuese ¼, por si burim deklarimi është shitja e banesës së përfutur nga privatizimi nga babai i saj. Më datë 06.09.1993, lidhet kontratë shitblerjeje sipas ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore” mes shitësit Ndërmarrja Komunale Banesa dhe blerësve {***}, {***}, Altina dhe {***} Xhoxhaj për apartamentin e banimit me sipërfaqe 89,16 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.
128. Me kontratën nr. 595 rep. dhe nr.101 kol., datë 08.02.2003, vërtetohet shitja e së njëjtës pasuri të sipërcituar (apartament me sipërfaqe 89,16 m² në rrugën “{***}”) ndërmjet {***}, {***}, {***}, Altina Xhoxhaj dhe {***}, të cilët me cilësinë e shitësit i shesin apartamentin blerësit, {***} (edhe ky titullar pronësie i këtij apartamenti). Këtë pasuri e shesin me çmimin 1.500.000 lekë, i cili i ndarë në 5 pjesë të barabarta, me nga 300.000 lekë secili shitës.
129. Më datë 05.02.2003, është lëshuar edhe certifikata e pronësisë me të gjashtë bashkëpronarët, {***} dhe {***}, si dhe {***}, {***}, Altina dhe {***} Xhoxhaj, ku edhe {***} dhe {***} mbajnë mbiemrin Xhoxhaj, ndërsa në kontratën e shitjes figurojnë me mbiemrin {***}. I vetmi sqarim i subjektit është se kontrata e datës 08.02.2003 është hartuar për shmangien e procesit gjyqësor. Në dosjen gjyqësore rezulton një kërkesë më datë 14.11.1991, me lëndë kërkesë për leje banimi, ku i nënshkruari {***} i drejtohet Komitetit Ekzekutiv që ta lejojë të jetojë në banesën e nipit të tij, {***}. Këtë kërkesë e bën për arsye se ishte larguar nga Shqipëria në vitin 1955 në Belgjikë dhe ishte kthyer në vitin 1991 dhe nuk dispononte letërnjoftim shqiptar. Edhe {***} i ka bërë kërkesë Komitetit Ekzekutiv më datë 14.11.1991, ku shpreh dakordësinë që shtetasi {***}, daja i tij, të jetojë në banesën e tij. Pra, rezulton që shtetasi {***} me bashkëshorten e tij të jenë strehuar në banesën e {***} para privatizimit të banesës (1993), por nuk del qartë si janë përfshirë në kontratën e shitjes me nr. 595 rep., nr. 101 kol., datë 08.02.2003.
130. Më datë 10.11.2003, me kontratën e shitjes nr. 6975 rep. dhe nr. 633 kol., apartamenti i banimit në fjalë shitet nga {***} te blerësit e cituar në kontratë, me çmimin 5.900.000 lekë (shumë e cila përbën edhe burimin e ndërtimit të karabinasë në {***}, Bathore). Subjekti i rivlerësimit këtë të ardhur e ka deklaruar si pjesë takuese ¼, por si burim të ndërtimit mbi truallin në {***}, Bathore. Pra si trualli, ashtu edhe ndërtimi në {***}, Bathore janë të regjistruar në emër të {***}, nënës së subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se burimi i deklaruar për truallin është me kursime familjare, kurse për ndërtesën shitja e apartamentit të privatizuar. Si rrjedhojë edhe pasuritë, po ashtu edhe paratë e investuara janë të prindërve të subjektit, ndaj deklarimi që ka bërë subjekti me pjesë takuese ¼ nuk është i saktë.
131. Gjithashtu, në deklaratën “vetting” nuk janë deklaruar këto pasuri nga subjekti, madje e pranon vetë, që vetëm prindërit mund të kenë pretendim nga prezumimi padrejtësisht i vetes si pronare e pasurisë së tyre, dhe kjo vetëm për efekt të plotësimit të formularit të deklarimit.
- Sa i përket cilësimit nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të pasurisë nr. 7 si deklarim i rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se jemi përpara pasaktësisë në deklarim.*

VI. Lidhur me rivlerësimin e kriterit profesional

132. Për subjektin e rivlerësimit ka pasur edhe një denoncim nga publiku, konkretisht nga shtetasi {***}, i cili denoncon subjektin në lidhje me mosdeklarimin e konfliktit të interesit për një çështje gjyqësore shqyrtuar pranë Gjykatës Kushtetuese dhe konkluduar me vendimin nr. 46, datë 03.03.2016, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupit gjykues të Gjykatës Kushtetuese. Ky proces është iniciuar nga denoncuesi {***} me kërkesë para Gjykatës Kushtetuese, me objekt shfuqizimin e tri vendimeve civile të gjykatave të zakonshme, përfshi edhe vendimin nr. 2565, datë 16.07.2015, të Gjykatës së Lartë Tiranë në lidhje me një proces gjyqësor civil, i cili ka pasur për objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të lidhur midis ish-Ndërmarrjes së Furnizimit të Komunikacioneve Durrës në cilësinë e shitësit dhe {***} në cilësinë e blerësit për shitjen e objektit “magazina” në rrugën {***}, në Tiranë. Denoncuesi, në procesin para Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur ndër të tjera edhe vendimin penal nr. 983, datë 09.09.2011, dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, ku babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë relator i kësaj çështjeje. Ndërkohë që trashëgimtarët “{***}” kanë qenë persona të interesuar në gjykimin kushtetues, dy nga këta trashëgimtarë kanë qenë të pandehur te Gjykata e Apelit Tiranë, të akuzuar për falsifikim në bashkëpunim të vendimit nr. 321, datë 16.09.2000, të Komisionit të Kthimit të Pronave Tiranë, gjykim penal i cili është pushuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me shkak parashkrimin e ndjekjes penale për të pandehurit {***} dhe {***}. Në përfundim të këtij gjykimi penal, trupi gjykues në përbërje të të cilit dhe ka qenë relator babai i subjektit të rivlerësimit ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 510, datë 01.04.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve {***} dhe {***}”.

Më parë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit/denoncuesit {***}, me vendimin e saj nr. 510, datë 01.04.2011, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve {***} dhe {***} për kryerjen e veprës penale të falsifikimit në bashkëpunim dhe, ndër të tjera, në këtë vendim është urdhëruar asgjësimi i objektit të falsifikimit vendimit nr. 321, datë 16.09.2000, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Urdhërimi i asgjësimit të objektit të falsifikimit nuk gjen pasqyrim në vendimin nr. 983, datë 09.09.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

133. Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, me mosveprimin e saj, nuk ka hequr dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 36/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Lidhur me këtë fakt, Komisioni e mbështet rezultatin e tij në shkresën e KLD-së me nr. 1171/1 prot., datë 12.04.2018, që e vlerëson kërkesën si rast që përbën shkak për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit, i cili duket se ka qenë në kushtet e papajftëshmërisë me ushtrimin e detyrës ose në kushtet e heqjes dorë në bazë të nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile. Për shkak të mospasjes kompetencë për nisjen e kësaj procedure, KLD sugjeron adresimin e rastit pranë Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese ku subjekti ka ushtruar veprimtarinë. Ndaj me mosveprimin e subjektit, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivelin e besueshëm, duke cenuar besimin e publikut. Në fakt, në çmimin e trupit gjykues të Kolegjit, Komisioni ka bërë një referencë të gabuar në nenin 36/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi kjo dispozitë është miratuar pas marrjes së vendimit nr. 46, datë 03.03.2016, pranë Gjykatës Kushtetuese. Në kohën kur është marrë ky vendim, ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” në nenin 36, germa “c” parashikonte: “Në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”. Duke iu referuar nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “Gjykata bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhjen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”, vlerësohet se Komisioni duhej t’i konstatonte veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në këndvështrimin e arsyeve serioze të

njëanshmërisë, që janë vërtetuar në gjykimin kushtetues me administrimin e vendimit penal nr. 983, datë 09.09.2011, dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Nga trupi gjykues i Kolegjit çmohet se subjekti i rivlerësimit vetëm duke iu referuar, në atë kohë, vendimit penal të sipërcituar, me kërkesë për dorëheqje do të mund të shmangte dyshimet serioze të njëanshmërisë së tij, pa cenuar kuorumin e Gjykatës Kushtetuese. Heqja dorë e subjektit të rivlerësimit nga kjo çështje, nuk do të cenonte, siç pretendohet prej tij, në asnjë moment standardin e Komisionit të Venecias mbi prevalimin e funksionimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese. Ky standard zbatohet në rastet kur nga heqja dorë e gjyqtarëve, mund të mos garantohet kuorumi i nevojshëm vendimmarrës për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjeve në Gjykatë Kushtetuese.

134. Subjekti ngre si shkak ankimor se nuk ka qenë kurrë në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të bëra me ligj dhe në asnjë rast tjetër. Sipas subjektit, ka gjykuar një çështje në përputhje të plotë me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit civil. Ndërsa në gjykimin penal në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku relator ishte babai i subjektit, është trajtuar pretendimi i parashkrimit të ndjekjes penale si shkak ankimor dhe nuk është gjykuar themeli i çështjes.
135. Në vlerësimin e Kolegjit konstatohet se në pamje të parë kemi të bëjmë me dy procese të ndryshme, ku njëri është penal dhe tjetri është civil. Palët në proces janë pothuajse të njëjtat, por me pozicione procedurale të ndryshme. Objektet gjithashtu janë të ndryshme për sa kohë ndryshojnë edhe juridiksionet, por shkak i konfliktit është i njëjtë, i cili vazhdimisht sillet rreth privatizimit të magazinave dhe truallit të tyre, ku të dyja palët kanë pretendimet e tyre nga më të ndryshmet, si dhe kanë paditur dhe kallëzuar njëra-tjetrën me objekte dhe kërtime të ndryshme gjyqësore duke u përfshirë në procese civile dhe penale. Ndërkohë, në këto procese me juridiksione të ndryshme kanë marrë pjesë në trupin gjykues si dhe në vendimmarrje, më parë babai {***} dhe më pas bija e tij Altina Xhoxhaj, në kohë të ndryshme dhe gjykata të ndryshme, duke e bërë në dukje të cenueshëm parimin e paanshmërisë së gjyqtarit. Nuk rezulton të jetë bërë kërkesë për heqje dorë nga ana e subjektit të rivlerësimit edhe pse është njohur me vendimin penal, i cili ndodhet në dosjen kushtetuese të administruar, provë e cituar edhe në parashtrimet shtesë të paraqitura nga përfaqësuesi i denoncuesit {***}.
136. Lidhur me parimin e paanshmërisë “Rezoluta me 10 parimet bazë”, e miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shprehet: “Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë si dhe të garantojnë aparcencën e paanshmërisë”.
137. Në çmimin e trupit gjykues të Kolegjit, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në funksion të kryerjes së detyrës së saj në mënyrë të paanshme, e zhveshur nga paragjykimet, në mënyrë që t’i garantonte të drejtat e palëve në proces për perceptimin e paanshmërisë së gjykatës, por edhe publikut për rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë, duhej të bënte kërkesë për heqje dorë pasi edhe nuk cenonte standardin e Komisionit të Venecias mbi prevalimin e funksionimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese dhe as kuorumin e kësaj gjykate, por kështu edhe garantonte parimin e paanshmërisë duke rritur kështu besimin e denoncuesit në sistemin e drejtësisë.
- Në analizë të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit me mosveprimin e tij, duke mos kërkuar heqjen dorë nga procesi kushtetues, për shkak të rrethanave ku ishte i përzier më parë edhe babai i tij në vendimmarrjen për shqyrtimin e të njëjtave fakte dhe prova si në procesin kushtetues, nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanshmërisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e*

testit objektiv të këtij parimi, për rrjedhojë ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

VII. Konkluzioni i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

138. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konstatimet dhe përfundimet e mëposhtme.

- 1) Komisioni bazuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka kryer një hetim administrativ duke respektuar parimet e procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me të drejtën e njohjes me dosjen, të drejtën për të paraqitur shpjegime dhe prova, të drejtën e njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore publike si dhe të drejtën e dëgjimit në këtë seancë. Gjatë zhvillimit të seancës publike, subjekti i rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së parashtrësive dhe provave në mbrojtje të pretendimeve të saj. Për rrjedhojë, procesi i zhvilluar në Komision rezulton të jetë në përmbushje të garancive procedurale dhe të drejtave të subjektit të rivlerësimit.
- 2) Trupi gjykues, pasi u njoh me të gjitha aktet objekt hetimi në fashikullin gjyqësor, shqyrtoi vendimin nr.17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 47, 48, 49, 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
- 3) Trup gjykues çmon përfundimisht se vendimi nr. 17, datë 03.05.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është marrë në bazë të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, një analize të plotë të fakteve juridike dhe financiare dhe provueshmërisë së plotë të tyre në përputhje me përcaktimet e neneve 33, 45, 52 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 4) Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit lidhur këto me provat e administruara në këtë çështje, arriti në konkluzionin se:
 - I. Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore të pasurisë nr. 1, apartament banimi me sipërfaqe të shfrytëzueshme 101 m², plus 10 m² sipërfaqe e përbashkët dhe në total pasuri me sipërfaqe 111 m², ndodhur në adresën: Bulevardi {***}, numër pasurie {***}, kati {***}, nr. {***}, Tiranë, regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë me kontratën e shitjes nr. 2908 rep. dhe nr. 629 kol., datë 07.12.2011, rezulton se bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimi financiar për të blerë pasurinë me vlerë 61.050 euro me të ardhurat e ligjshme të deklaruara dhe të ardhurat e ligjshme të provuara prej tij dhe personit të lidhur, për këtë arsye bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016 ka kryer deklaram të rremë, si dhe bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 ka kryer fshehje pasurie.
 - II. Nga sa rezultoi e provuar dhe e analizuar për pasurinë nr. 4 (likuiditete), rezulton një diferencë negative prej 1.288.258,57 lekësh, e cila është e ndryshme nga ajo që ka përlloritur Komisioni (-1.972.969 lekë). Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo shumë është e pajustificuar dhe, për pasojë, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj nuk shpjegon bindshëm burimin

e ligjshëm të këtyre shumave monetare dhe, për më tepër, subjekti Xhoxhaj përpiqet të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në likuiditete. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj dhe personi i lidhur me të nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për t'i justifikuar këto shuma monetare.

- III. Lidhur me pasurinë tokë bujqësore, me sipërfaqe 666 m², me vendndodhje në fshatin {***}, Bathore, me ¼ pjesë takuese, vlera totale 500.000 lekë + banesë karabina filluar ndërtimi në vitin 2000 me pjesë takuese ¼, me vlerë 3 milionë lekë, subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj vlerësohet se ka bërë deklaram të pasaktë.
- IV. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë banesë karabina, e filluar së ndërtuari në vitin 2000, në pjesë takuese ¼ me vlerë tre milionë lekë në {***}, Bathore, subjekti i rivlerësimit Altina Xhoxhaj vlerësohet se ka bërë deklaram të pasaktë.
- V. Në analizë të denoncimit të shtetasit {***} ndaj subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se me mosveprimin e tij, subjekti i rivlerësimit, duke mos kërkuar heqjen dorë nga procesi kushtetues, për shkak të rrethanave ku ishte i përfshirë më parë edhe babai i saj në vendimmarrjen për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore që kanë pasur lidhje me të njëjtin objekt material gjykimi dhe konflikti mes trashëgimtarëve “{***}” dhe denoncuesit {***}, si në Gjykatën e Apelit Tiranë, edhe në procesin kushtetues, nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanësisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e testit objektiv të këtij parimi, për rrjedhojë ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në pikat 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall në Tiranë, më datë 24.10.2018.

ANËTARE

Natasha MULAJ
nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI
nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA
nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA
nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, po parashtroj më poshtë argumentet e një arsyetimi paralel me arsyetimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 24.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
2. Arsyetimi i këtij mendimi paralel lidhet me qëndrime të ndryshme në raport me qëndrimin e mbajtur nga trupa gjyquese për disa nga shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, por që nuk afekton qëndrimin tim pro vendimmarrjes së trupës për lënien në fuqi të vendimit nr. 17, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj.
3. Kam mbështetur dhe kam votuar pro argumenteve të dhëna nga trupa gjyquese në analizë të shkaqeve të ankimit të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit për pjesën më të madhe të tyre dhe, duke veçuar në mënyrë të përmbledhur atë që trupa gjyquese ka pranuar në lidhje me pasurinë apartament prej 101 m² të ndodhur në Tiranë, Bulevardi {***}, si një pasuri për të cilën subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me burimin e financimit të blerjes së kësaj pasurie. Kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep. e nr. {***} kol, datë 07.03.2005, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur {***} dhe shtetasve {***} e shoqërisë “{***}” SHPK para noterit, përbën në gjykimin tim provë të plotë në lidhje me atë që përshkruhet aty dhe konkretisht në lidhje me faktin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur së bashku kanë paguar shumën prej 41.850 USD për porositjen e financimit e apartamentit të parë në vitin 2003, transferimi i të cilit te personi tjetër {***}, ka shtuar në vlerë burimin e financimit të apartamentit që është në bashkëpronësi të subjektit e personit të lidhur sot. Ky fakt që provohet nga kontrata e sipërmarrjes, nuk është kontestuar dot nga subjekti i rivlerësimit jo vetëm për shkak të vlerës provuese që ka një kontratë e tillë, e cila sipas nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile përbën provë të plotë, por edhe për shkak të faktit që nga hetimi administrativ nuk rezultoi se subjekti i rivlerësimit të kishte provuar në mënyrë të plotë e shteruese faktin e pretenduar prej saj se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga bursa e puna e personit të lidhur në Itali gjatë periudhës 1992-2001. Në këto rrethana, kam gjykuar se ajo çka ka pretenduar subjekti për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pra që është vetëm nga të ardhurat e personit të lidhur, nuk provohet të jetë e vërtetë, për shkak se nëpërmjet një akti zyrtar me fuqi të plotë, rezulton e kundërta. Për pasojë, kam çmuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në këtë mënyrë në kushtet kur është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ketë bërë deklaram të rremë për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie në kuptim të nenit 61/3, i parë lidhur me nenin 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet ligjore për vendosjen ndaj saj të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
4. Kam ndarë të njëjtin qëndrim me trupën gjyquese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit edhe për sa u përket qëndrimeve që janë mbajtur në lidhje me çështjen e pasurisë nr. 2 dhe konkretisht pasuritë apartament e truall, të ndodhura në zonën e Ishmit, duke çmuar se deklaramet e subjektit të rivlerësimit për këto pasuri janë të sakta, në përputhje me ligjin dhe ligjërisht të justifikueshme për sa i përket burimit të krijimit të tyre.
5. Kam ndarë gjithashtu të njëjtin qëndrim me trupën gjyquese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për sa i përket qëndrimit të mbajtur në çështjen nr. 5 të vendimit që i përket

verifikimit të deklaramit të subjektit të rivlerësimit për destinacionin e kredisë së marrë e deklaruar në vitin 2003, me të cilën është financuar blerja e një apartamenti nga motra e subjektit të rivlerësimit, duke e gjetur këtë situatë të deklaruar saktë e në përputhje me ligjin dhe, si të tillë, jo një shkak për shkarkimin e subjektit.

6. Kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën e trupës gjyqësore dhe kam votuar kundër shkaqeve të shkarkimit që paraqiten në çështjen nr. 4, 6 e 7, si dhe me rivlerësimin e kriterit profesional, të cilat në vlerësimin tim nuk janë shkaqe që përlligjin vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
7. Në lidhje me shkakun e shkarkimit që arsyetohet në çështjen nr. 4 të vendimit dhe që i përket “pasurisë likuiditet”, kam ndarë qëndrim të ndryshëm me trupën gjyqësore duke mbajtur qëndrimin se kjo situatë faktike nuk duhej përdorur si shkak për shkarkimin e subjektit në çështjen konkrete.
8. Sipas vendimit të nr. 17, datë 03.05.2018, të KPK-së, subjekti i rivlerësimit, sipas analizës financiare të kryer gjatë procesit të rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme pasurinë prej 1.972.969 lekësh, shifër e cila shfaqet si shumatore e diferencave të pajustificuara të rezultuara për vitet 2007 (-450.097 lekë), 2009 (-965.119 lekë) dhe 2015 (-557.753) lekë. Analiza financiare e kryer gjatë hetimit administrativ nga Komisioni mbështetet në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për këto vite, duke arritur në konkluzionet e evidentimit të diferencave të mësipërme.
9. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka paraqitur një sërë pretendimesh që lidhen me analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke e gjetur atë padrejtë e të pasaktë, në disa drejtime.
10. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në verifikim dhe analizë të shkaqeve të ngritura në ankim, u krye një analizë financiare nga këshilltari ekonomik i Njësisë së Shërbimit Ligjor, në të cilën u reflektuan disa nga pretendimet e paraqitura nga subjekti në ankim dhe që u gjenden të drejta prej këshilltarit ekonomik, analizë e cila e çoi shumën për diferencën e pambuluar në 1.288.258,57 lekë, si shumatore e diferencave për vitet 2007 (-383.561,25 lekë), 2009 (-85.458,45 lekë) dhe 2015 (-819.238,57 lekë).
11. Në këtë analizë financiare të kryer në Kolegj nuk u konsideruan e përlllogaritën disa nga pretendimet e subjektit të prezantuara në ankim e që në gjykimin tim duhej të ishin bërë pjesë e kësaj analize. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar zhvillimin e disa udhëtimeve jashtë vendit në vitin 2007 e 2009 të kryera për llogari të funksionit shtetëror si gjyqtare e të financuara nga fondet e projekteve që kanë organizuar takimet. Subjekti rivlerësimit nuk ka mundur të sjellë dokumentacion për të provuar këtë pretendim, duke qenë se KLD-ja është përgjigjur se aktivitetet nuk janë financuar prej saj e për pasojë nuk disponon dokumentacion, por pavarësisht kësaj, subjekti ka këmbëngulur në drejtim të vërtetësisë së këtij fakti.
12. Pretendimi i parë lidhet me udhëtimin e kryer në Romë në datat 01-04 prill të vitit 2007 në kuadër të një projekti binjakëzimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë të Magjistraturës Italiane, për të cilin KLD-ja ka dërguar përgjigje se nuk disponon dokumentacion, sepse këto udhëtime financoheshin nga BE-ja e Këshilli i Evropës, Euralius e institucione homologe. Nga një këqyrje e faqes zyrtare të Këshillit të Lartë të Magjistraturës Italiane¹ gjejmë të publikuar raportin zyrtar të hartuar në kuadër të projektit të binjakëzimit të titulluar “Progetto di gemellaggio tra il Consiglio

¹ <http://astra.csm.it/AI/pdf/AI-Twinning-ProgettoGemellaggio1.pdf>

Superiore della Giustizia Albanese, il Consiglio Superiore della Magistratura Italiana in cooperazione con il Consiglio Superiore della Magistratura Spagnola“Supporto al Consiglio Superiore della Giustizia Albanese ed al suo Ispettorato”. Në faqen 4 të këtij raporti, flitet për një vizitë studimore të organizuar në kuadër të këtij projekti në Romë, në fillim të muajit prill 2007, kohë që përkon me kohën e pretenduar prej subjektit.

13. Pretendimi i dytë për udhëtimet e subjektit lidhet me udhëtimin e zhvilluar prej saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2007, në të cilin ajo ka lindur fëmijën e saj të dytë. Subjekti ka pretenduar se qëndrimi atje i është siguruar nga një çift miqsh të cilët kanë përpiluar një deklaratë noteriale në të cilën deklarojnë se kanë mbajtur në shtëpinë e tyre në këtë periudhë subjektin së bashku me familjen, duke i asistuar në drejtim të shpenzimeve të jetesës me qëllimin për ta mbështetur në atë moment të rëndësishëm jetësor. Në deklaratën noteriale të nënshkruar prej tyre, konstatohet se ata deklarojnë si adresë të banimit të tyre në kohën e qëndrimit të subjektit të njëjtën adresë që gjejmë të shënuar edhe në dokumentin spitalor që tregon se subjekti ka qenë e përfshirë në programin e ndihmës ekonomike për shkak të lindjes.
14. Pretendimi i tretë i subjektit lidhet me udhëtimin e kryer në Madrid, më 31 maj deri 4 qershor 2009. Për këtë udhëtim subjekti ka pretenduar se është kryer në kuadër të projektit të binjakëzimit për shkak të qenies anëtare e KLD-së, për të cilin nuk ka dokumentacion të siguruar nga KLD-ja. Ky pretendim rezulton se mbështetet nga verifikimi i disa të dhënave që vetë subjekti jep në lidhje me anëtarët e tjerë të KLD-së që kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtin udhëtim, pretendim i cili u verifikua si i vërtetë nga këqyrja e drejtpërdrejtë e sistemit TIMS, i aksesueshëm nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në zbatim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Për më të tepër, u mbështet edhe nga këqyrja e raportit të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit në Spanjë, në faqen 8 të tij ku raportohet për vizitën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit².
15. Pretendimi i katërt i subjektit lidhet me udhëtimin e datës 4-7 nëntor 2009, të organizuar në Portugali dhe të financuar nga Euralius. Në faqen zyrtare të Euralius gjendet raporti final i Euralius II, i cili në faqen 17 të tij konfirmon pikërisht organizimin e një vizite studimore (*study visit*) në Lisbonë në datat e pretenduara prej subjektit, me anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë³.
16. Pretendimi i pestë i subjektit lidhet me pjesëmarrjen në një sesion trajnimi për të cilin ai është pajisur me certifikatë, që vërteton pjesëmarrjen.
17. Të gjitha pretendimet e mësipërme të subjektit për udhëtime jashtë vendit, ku pretendohet se shpenzimet nuk janë mbuluar prej saj, në fakt janë llogaritur nga analiza financiare edhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit si shpenzime të kryera prej subjektit dhe që kanë ngarkuar zërin shpenzime në analizat periodike që janë bërë. Pretendimet e subjektit për shpenzime të pakryera prej saj e të verifikuara më dokumentacionin e përmendur më lart nuk janë konsideruar si të tilla prej trupës gjyqësore.
18. Lidhur me pretendimet e subjektit për udhëtimet, vlerësoj se pretendimet për udhëtimet e kryera për shkak të funksionit provohen se janë kryer pikërisht në këto kushte, kjo duke analizuar të dhënat e publikuara në faqet zyrtare të institucioneve ndërkombëtare (që janë lehtësisht të verifikueshme edhe për publikun), të cilat në vlerësimin tim duhet

² <https://rm.coe.int/komisioni-evropian-p-r-efikasitetin-e-drejt-sis-cepej-manual-per-zhvil/168074826e>

³ http://www.euralius.eu/old/images/pdf/Final_Report_EURALIUS_II.pdf

të kenë vlerën provuese të faktit të njohur botërisht në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për të cilat nuk ka më nevojë për prova të mëtejshme. Në këto kushte, vlerësoj se shpenzimet e konsideruara se janë kryer prej subjektit në këto udhëtime duhej të zbriteshin nga zëri shpenzime në analizën financiare të realizuar për subjektin.

19. Në këtë kontekst, gjithashtu në analizën financiare të Komisionit dhe Kolegjit, edhe vlera e shpenzimeve e llogaritur për periudhën e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilën subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të shtetasve që e kanë strehuar (*shpjeguar në paragrafin 13 më sipër*), do duhej të ishte konsideruar të paktën nën një metodologji të ndryshme nga ajo që përdoret për të gjitha rastet e tjera, kur subjektet nuk paraqesin asnjë dokument apo të dhënë të verifikueshme për të provuar pretendime të kësaj natyre. Gjykoj se në të tilla situata, qoftë Komisioni, qoftë Kolegji i Apelit, do të duhet të analizojë e vlerësojë pikërisht akte të kësaj natyre apo deklaratata personale të cilat do të përdoren për të provuar një të dhënë të tillë, siç është mikpritja në banesën e një personi të një rrethi miqësor apo shoqëror. Në rastin konkret, në deklaratën e shtetasve {***} dhe {***} konstatohet një element i përbashkët për sa i përket vendbanimit të deklaruar prej tyre me atë të hedhur në dokumentin spitalor, i cili përfaqëson të njëjtin vendbanimin për subjektin, duke i dhënë në këtë mënyrë një vlerë të arsyeshme provuese deklaramit të bërë prej këtyre shtetasve. Në situatën që ky fakt do të kishte përcaktuar fatin e zgjidhjes së çështjes, mendoj që Kolegji do të duhej ta kishte verifikuar atë nëpërmjet shërimit të të metave procedurale që akti konstatohet se ka, por kjo rrethanë nuk pengon kryerjen e një analize logjike mbi të dhënat e këtij dokumenti.
20. Të gjitha argumentet e mësipërme për udhëtimet, në gjykimin tim, vlejnjë për të përcaktuar saktësinë e shumës së likuiditeteve të konsideruara si të pambuluara me burime të ligjshme. Në rast se analizës financiare të kryer nga Kolegji do t'i nënshtroheshin edhe këto elemente, logjikisht do të kishim një rezultante të ndryshme për këtë diferencë, më të vogël se sa shifra prej 1.288.258,57 lekësh.
21. Për këto arsye, në vijim të këtij arsyetimi, nuk e kam gjetur me vend përdorimin e kësaj shume si diferencë të pambuluar me burime të ligjshme, si shkak për shkarkimin e subjektit sepse:
 - Së pari*, ekzistojnë disa rrethana që më çojnë në konkluzionin se kjo shumë nuk përfaqëson realisht gjendjen financiare të subjektit.
 - Së dyti*, analiza financiare nuk është e mbështetur në dokumentacion financiar të pakontestueshëm, i cili do të na krijonte tablonë reale të situatës financiare të subjektit, për të cilën duhej të gjykonim për peshën që proporcionalisht do të kishte kjo diferencë në raport me parimin kushtetues të provimit bindshëm të burimit të ligjshëm të pasurive, por është e ndërtuar mbi vlerësime të natyrës subjektive në lidhje me shpenzimet e subjektit për këtë periudhë.
 - Së treti*, kjo shumë duke përdorur argumentet e mësipërme dhe të dhënat e përpunuara prej këshilltarit ekonomik, duke i zbritur shumën për shpenzimet e përmendura më lart, të cilat janë 196.274 lekë për udhëtimet e punës dhe 613.591 lekë për udhëtimin në ShBA në vitin 2007, mund të arrihte në një vlerë prej rreth 478.392 lekësh ose në një vlerë akoma më të vogël. Mungesa e sigurisë për vetë shumën e konsideruar si të pambuluar me burime të ligjshme, si edhe vlera relativisht e ulët e kësaj shume në raport me vitet e punës së subjektit e personit të lidhur dhe të ardhurat e realizuara gjatë këtyre viteve, mendoj që nuk krijojnë një premisë të qëndrueshme për ta konsideruar këtë shumë (diferencë) si një rrethanë të konsideruar prej ligjit si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

22. Në analizë të dispozitave ligjore, neni 61, pika 3 e neni 33, pika 5, germa “ç”, mendoj se nuk gjendemi para një përcaktimi ligjor të ndonjë vlere dysHEME, e cila do të shërbente si kufi për të konsideruar se subjekti nuk justifikon pasuritë me burime të ligjshme. Përpos kësaj situate, parimi kushtetues i sanksionuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon detyrimin e subjektit se ai duhet “ të provojë bindshëm” burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave duke përcaktuar në këtë mënyrë një rol vendimtar të së drejtës diskrecionare të organeve të rivlerësimit për të kualifikuar pas një shqyrtimi të plotë çdo rast specifik, nëse provohet bindshëm ose jo ky element. Gjithashtu, nga analiza e dispozitës vihet re se këtij detyrimi të subjektit, Aneksi i Kushtetutës nuk i bashkëngjit një sanksion konkret, prandaj edhe mendoj që përcaktimi i mësipërm, “të provojë bindshëm”, është një parim kushtetues i cili duhet të udhëheqë të gjithë procesin e rivlerësimit, por jo automatikisht një sanksion që shkakton shkarkimin nga detyra. Në këtë kontekst, gjykoj se është e nevojshme që vlera e konsideruar si e pajustificuar të jetë një vlerë e sigurt dhe e mbështetur në analizë financiare, mbështetur në një bazë dokumentare apo të dhënash të cilat gëzojnë përgjithësisht një nivel të pranueshëm të dakordësisë, në mënyrë që vlerësimi mbi relevancën e vlerës (diferencës së evidentuar), mbështetur mbi parimin e diskrecionit, i lidhur ngushtë dhe me parimin e proporcionalitetit, të jetë i ndërtuar mbi një situatë faktike të qëndrueshme dhe sa më të saktë.
23. Për të gjitha argumentet e mësipërme, kam vlerësuar se përdorimi i argumentit për likuiditetet e pajustificuara në çështjen konkrete që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj, nuk mund të ishte një kriter për shkarkimin e saj në kuptim të nenit D të Aneksit Kushtetues apo nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
24. Në lidhje me qëndrimin e trupës gjyquese në çështjet nr. 6 dhe 7 të vendimit, jam shprehur dhe kam votuar kundër përdorimit të rrethanave që pasqyrohen në këto çështje si shkaqe për shkarkimin e subjektit. Për lehtësi arsyetimi, duke qenë se përfaqësojnë dy pasuri të paluajtshme, tokë dhe ndërtesë, të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me njëra-tjetrën, por edhe sepse përfaqësojnë të njëjtën situatë faktike e ligjore të trajtuar nga trupa gjyquese, po e përmbledh qëndrimin tim për këto dy çështje në një argument të vetëm.
25. Në lidhje me këto dy konstatime të Komisionit dhe që lidhen me deklaratime të subjektit të rivlerësimit në mënyrë të gabuar në deklaratat periodike të viteve 2003 e 2004 në raport me pasurinë truall e ndërtim të ndodhur në {***}Tiranë, në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, të cilat janë deklaruar prej subjektit si pjesë takuese pasurore në atë kohë dhe jo më pas, dhe janë shpjeguar se ka qenë një perceptim i gabuar për shkak të qenies në një ekonomi të përbashkët dhe jo të pasjes nga subjekti të një titulli pronësie mbi këto prona, trupa gjyquese e Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, ka konkluduar se këto deklaratime në deklaratat periodike përfaqësojnë pasaktësi në deklarime që nuk kanë pasur qëllim të fshehin pasuri apo të japin deklarime të rreme. Pavarësisht këtij konkluzioni, trupa gjyquese i ka konsideruar këto deklarime të pasakta si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, pika 3 e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
26. Duke rënë dakord me përcaktimin e trupës gjyquese për sa i përket konstatimit të faktit se këto deklarime përfaqësojnë pasaktësi në deklaratat periodike dhe jo fshehje dhe as deklarim të rremë nga ana e subjektit, kam votuar kundër qëndrimit të trupës që këto konkluzione të jenë të përdorshme si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

27. Vlerësoj se pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit, aq më shumë kur ato janë të zhveshura nga përpjekja për të fshehur pasuri apo për të deklaruar në mënyrë të pasaktë pasuri, burim të ardhurash, interesa, në raport me parashikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të konsiderohen si shkak shkarkimi sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
28. Së pari, siç rezulton dhe është pranuar edhe nga shumica, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratat periodike të drejta pronësie në raportin ¼ në pasuritë truall e ndërtesë, të ndodhura në {***} e të regjistruara që në fillim në emër të nënës së tij. Këto të drejta pasurore nuk janë deklaruar më prej subjektit në deklaratën e pasurisë “vetting” dhe subjekti ka shpjeguar se deklarimi i tyre në deklaratën periodike ka qenë një kuptim i gabuar i saj i detyrimeve për deklarim dhe trajtimi jo i drejtë i kontributit familjar në krijimin e këtyre pasurive në raport me të drejtat e pronësisë mbi to. Për këtë arsye, ajo nuk i ka deklaruar më ato më pas dhe as në deklaratën e pasurisë “vetting”, sepse realisht nuk i gëzon këto të drejta të cilat i përkasin nënës së saj.
29. Vetë shumica pranon se këto deklarime përbëjnë pasaktësi në plotësimin e deklaratave periodike të viteve 2003 e 2004 dhe nuk përfaqësojnë përpjekjeje për të fshehur pasuri apo për të deklaruar në mënyrë të pasaktë, por përsëri i ka konsideruar si shkaqe që shkaktojnë shkarkimin e subjektit nga detyra, në zbatim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e nenit 33, pika 5, germet “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016.
30. Mendoj se në zbatim të nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit, përcaktohet qartë se objekt i verifikimit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve që lidhen me pasurinë e subjektit të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi është para së gjithash deklarata e pasurisë “vetting”, e cila përpilohet në përputhje me rregullat e reja të miratuara në Aneksin e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Kjo deklaratë, bashkë me deklaratat periodike i nënshtrohen kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në përfundim të të cilit institucioni harton një raport përfundimtar. Pjesë konkluduese e këtij raporti është parashikimi i pikës 5 të këtij neni, në të cilin bëhen prezent gjetjet e ILDKPKI-së për pasaktësitë, fshehjet, deklaratimet e rreme, mosjustifikimin e burime të ligjshme apo konfliktin e interesit.*
31. Edhe në raportin që harton ky institucion, ligji nuk parashikon që konkluzionet e tij duhet t’i referohen kontrollit të saktësisë e vërtetësisë së deklaratave periodike, por asaj *vetting*, sipas parashikimit kushtetues. Sigurisht që deklaratat periodike, të cilat sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të përdoren si provë gjatë procesit të rivlerësimit, shërbejnë për të arritur në konkluzione sa më të drejta në lidhje me atë çka ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë “vetting”, por deklaratimet e bëra në këto deklarata në vetvete nuk janë objekt i verifikimit të vërtetësisë e saktësisë së tyre në kuptim të procesit të rivlerësimit, por kanë vlerën e provës, krahas provave të tjera të mbledhura gjatë hetimit administrativ nga organet apo të paraqitura nga subjekti, për të vlerësuar deklaratën e pasurisë “vetting”, të hartuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
32. Në këtë kuptim, mendoj që *së pari* fakti që Komisioni dhe trupa gjyquese e Kolegjit ia kanë nënshtuar shqyrtimit dhe analizës në funksion të procesit të rivlerësimit, një pasaktësi të konstatuar në deklaratat periodike të viteve 2003 e 2004 dhe jo në deklaratën e pasurisë “vetting”, është një proces që del si rregull përtej qëllimit të përcaktuar në ligj. Analiza e një pasaktësie në këto deklarata periodike do t’i shërbente,

në gjykimin tim, verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë “vetting” apo mund të ishte pjesë e vlerësimit tërësor të subjektit në raport me komponentin pasuri, por jo një rrethanë që mund të përdorej si shkak autonom për shkarkimin e subjektit.

Së dyti, për më tepër që vetë trupa gjykuese pranon se pasaktësia në këto deklarata nuk është e shoqëruar me qëllimin për të fshehur një pasuri apo për të deformuar pasqyrimin e një të dhëne, që do të thotë që nuk gjendemi as përpara fshehjes së pasurisë dhe as përpara deklaramit të rremë, e bën këtë rrethanë të papërdorshme si një shkak për ta shkarkuar subjektin nga detyra.

33. Neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.” Në vlerësimin tim, kjo do të thotë se edhe nëse pasaktësia në deklaratat periodike do të ishte objekt verifikimi i këtij procesi në mënyrë të posaçme, përsëri, që kjo pasaktësi të konsiderohej se mund të përdorej si një shkak për shkarkimin e subjektit, duhej të ishte e shoqëruar me përpjekje për të fshehur pasurinë apo për të deklaruar me qëllim në mënyrë të pasaktë, që në thelb do të thotë që duhej të kishim të bënim me fshehje apo deklarim të rremë. Vetëm pasaktësitë, të cilat do të mund të kualifikoheshin si fshehje apo deklarim i rremë, do të ishin të tilla që të shkaktonin shkarkimin e subjektit në zbatim të parimit kushtetues të nenit D, pika 5 e zberthyer në nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5, gerrat “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016.
34. Për të gjitha sa thashë më lart, kam votuar kundër këtij shkak si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj.
35. Kam votuar gjithashtu kundër qëndrimit të mbajtur nga trupa gjykuese lidhur me rivlerësimin profesional dhe zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për rastin në fjalë. Në gjykimin tim, analiza e kësaj situate duhet të zhvillohet në dy drejtime në mënyrë të integruar e kumulative.
Së pari, duhet të analizohet veprimi i subjektit të rivlerësimit në raport me rrethanat e faktit dhe kuadrin ligjor në fuqi.
Së dyti, duhet të analizohet koncepti/standardi i cenimit të besimit të publikut në raport me veprimin e subjektit.
36. Në lidhje me aspektin e parë, në analizë të kuadrin ligjor në fuqi dhe të rrethanave që bëhen prezente në çështje, çmoj se nuk provohet se kanë ekzistuar për subjektin e rivlerësimit shkaqe që mund të konsideroheshin si arsye serioze njëanshmërie në kuptim të nenit 36/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për të cilat subjekti duhej të kishte kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Nga analiza e rrethanave të faktit, rezulton se subjekti ka marrë pjesë në një gjykim kushtetues në të cilin është kërkuar shfuqizimi i disa vendimeve të gjykatave civile për shkak të shkeljes së parimit të paanësisë në gjykim, si rezultat i pjesëmarrjes në këto gjykime i gjyqtarëve që kishin shkaqe papajtueshmërie. Procesi është iniciuar nga kërkuesi {***}, i cili shfaqet me cilësinë e denoncuesit në procesin e rivlerësimit. Në fashikullin e gjykimin të kësaj çështjeje, në Gjykatën Kushtetuese ka qenë i administruar edhe vendimi penal i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 983, datë 09.09.2011, në të cilin ka marrë pjesë si gjyqtar, me cilësinë e relatorit, babai i subjektit, {***}. Sipas këtij vendimi penal, rezulton se është vendosur pushimi i gjykimin të çështjes penale në ngarkim të dy shtetasve të familjes {***} (pala

kundërshtare e kërkuesit në procesin civil) të cilët kanë qenë akuzuar për falsifikim dokumentesh sipas nenit 186 të Kodit Penal, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ushtrimit të ndjekjes penale.

37. Rezulton se nga pretendimet e kërkuesit në gjykimin kushtetues është pretenduar shkelja e kryer nga gjykatat në shkallë të ndryshme, në drejtim të marrjes pjesë në atë proces të gjyqtarëve të ndryshëm, të cilët kanë qenë në kushtet e papajtueshmërisë me detyrën e gjyqtarit për shkaqe të ndryshme. Në këndvështrim të kësaj kërkese, kërkuesi ka pretenduar zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, objekti i gjykimit kushtetues ka qenë pikërisht pretendimi në lidhje me këtë shkelje dhe në fakt, edhe nga vendimi rezulton se vetëm ky pretendim i kërkuesit është konsideruar si i legjitimuar për shqyrtim. Kjo rrethanë tregon, në gjykimin tim, se i gjithë vlerësimi që Gjykata Kushtetuese do të duhej t'i bënte çështjes do të kishte lidhje me këto elemente dhe jo me të drejtën materiale në konflikt. Për më tepër, kërkuesi nuk rezulton të ketë ngritur asnjë pretendim në lidhje me vendimin penal në të cilin babai i subjektit ka qenë relator i çështjes.
38. Shpjegimi i mësipërm më duket i nevojshëm për të mbështetur argumentin vijues se përse mendoj që nuk ekzistonin shkaqe për heqjen dorë nga gjykimi për subjektin e rivlerësimit. Përcaktimi i bërë në nenin 36/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, në lidhje me “arsye serioze njëanshmërie”, gjykoj se kërkon një vlerësim dhe analizë të rrethanave konkrete për të konkluduar se shkaqet ekzistonin. Në mungesë të një referimi konkret në ligjin për Gjykatën Kushtetuese për rastin në fjalë, pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të gjykimit kushtetues, i cili trajton dhe gjykon aspekte të natyrës kushtetuese dhe jo aspekte që lidhen me zgjidhjen konkrete të çështjeve e zbatimin e ligjit material apo procedural, si edhe me vlerësimin e provave, mund të analizohen sidoqoftë definicionet që përdor Kodi i Procedurës Civile për të kualifikuar pjesëmarrjen e një gjyqtari në një çështje si në kushte paanshmërie, i cili në vlerësimin tim është një përkufizim më i ngushtë se sa ai që i lejohej të përdorë gjyqtari kushtetues, por që gjithsesi mund të përdoret si referues në mungesë të një të rregullimi specifik për gjyqtarin kushtetues.
39. Kur nuk ekzistojnë arsye të tjera, të cilat tregojnë për njëanshmëri, neni 72 i Kodit të Procedurës Civile parashikon në pikën 4 rastin se kur një gjyqtar, është “përzier” (termi që përdor shumica) në të njëjtën çështje, duhet të japë dorëheqjen. Kjo dispozitë parashikon se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë”. Kjo dispozitë qartazi përcakton kufizime për pjesëmarrjen e gjyqtarit në një proces ku ai vetë ka pasur një rol procedural në një fazë tjetër të procesit dhe jo të ndonjë familjari të gjyqtarit. Në vlerësimin tim, ligji nuk ka dashur të barazojë në këto raste ushtrimet e funksionit të një gjyqtari me rastet e ushtrimit të funksionit të një familjari të gjyqtarit, i cili është gjyqtar gjithashtu, sa kohë që nuk provohet një interes personal objektiv jashtë rolit dhe detyrës së gjyqtarit, që do i përfshinte këto subjekte në një situatë të konfliktit të interesit.
40. Në këtë kuptim, vetëm kjo rrethanë, e cila lidhet me situatën rastësore të gjendjes në pozicionin e gjyqtarit të subjektit dhe babait të saj në lidhje me një mosmarrëveshje të njëjtë në një kuptim të gjerë e faktik, por jo të njëjtë në kuptimin që legjislacioni procedural u jep çështjeve të njëjta që janë: *të njëjta palë, i njëjti objekt, i njëjti shkak,*

nuk përbën në gjykimin tim një shkak serioz njëanshmërie. Që një rrethanë të konsiderohej si e tillë, duhej të ishte shoqëruar me të dhëna të tjera të cilat tregonin për ekzistencën e një interesi të përbashkët në çështje. Vetëm kjo situatë në vlerësimin tim nuk provon ekzistencën e arsyeve serioze, sipas nenit 36/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

41. Edhe në këndvështrim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, nuk gjendet asnjë parashikim që do ta kishte përcaktuar rrethanën e mësipërme si një situatë që krijonte konflikt interesi, për sa kohë që asnjë interes privat i subjektit apo babait të saj nuk pretendohet se ka qenë i mundur të afektohet nga vendimmarrja në procesin kushtetues.
42. Në konkluzion, në lidhje me këtë çështje, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk provohej se gjendej në një situatë të ekzistencës së arsyeve serioze të njëanshmërisë, e cila ta detyronte atë të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes.
43. Së dyti, vlerësoj se diskutimi mbi cenimin e besimit të publikut duhet të jetë detyrimisht i lidhur me veprime apo sjellje të subjektit të rivlerësimit që konsiderohen se përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi. Vetëm pasi konstatohet një rrethanë e tillë mund të vijohet me analizën nëse kjo sjellje ka cenuar ose jo besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.”
44. Në këto kushte, duke e konsideruar veprimin e mësipërm jo si një shkelje të kryer në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi, do të konsideroja të pambështetur diskutimin më pas të cenimit të besimit të publikut në kuptim të kësaj dispozite. Fakti se njëra palë e procesit ndihet e pakënaqur, e zhgënjyer apo në mungesë besimi nga një vendim i caktuar dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nuk është domosdoshmërisht një element i mjaftueshëm për ta kualifikuar atë si cenim të besimit të publikut, i cili përfaqëson në gjykimin tim një kategori shumë më të gjerë individësh që përgjithësisht duhet të jenë jashtë kategorisë së palëve të një procesi në të cilin subjekti ka kryer funksionet e magjistratit, për sa kohë palët e përfshira në një proces gjyqësor bëjnë vlerësimin e subjektit nga një këndvështrim krejt personal e individual që lidhet përgjithësisht, natyrshëm me fatin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.
45. Përfundimisht, për këto shkaqe, kam vlerësuar se situata e trajtuar nga shumica si më sipër nuk paraqet rrethanat e kërkuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për t’u përdorur si një shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

GJYQTARE

Ina RAMA
nënshkrimi